

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Ekspertët e Partisë Socialiste ka konstatuar një angazhim të dobët të mbështetësve të saj në fushatën për zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit. Sipas raportit kofidencial për zgjedhjet, në nivel kombëtar, vetëm 60 e mbështetësve të PS janë angazhuar në fushatën e saj elektorale. Qarqet pararojë në angazhimin më të madh të mbështetësve janë Durrësi me 88.9% dhe Shkodra me 85.6%, ndërsa ato me angazhimin më të vogël të mbështetësve janë Dibra me 48.0% dhe Fieri me 49.3%. “Padyshim që këtu ka ndikuar edhe situata e përgjithshme politike në prag të zgjedhjeve ku ndër elementët më kryesorë ishte pasiguria për pjesëmarrjen e opozitës në zgjedhje. Ky element, ishte thelbësor në krijimin e perceptimit për një fitore të lehtë të PS përkundrejt forcave të tjera politike pjesëmarrëse në zgjedhje, i cili perceptim mbizotëroi edhe pas regjistrimit të opozitës në zgjedhje. Pasqyrimi i këtij perceptim ishte niveli i ulët i angazhimit të mbështetësve të PS në fushatën elektorale. Vetëm 60% e mbështetësve të PS u bënë pjesë aktive e fushatës së PS. Angazhim më të lartë në fushatë treguan koordinatorët elektorale 96% e të cilëve u përfshinë aktivisht në fushatë. Pozitiv dhe inkurajues për të ardhmen është edhe niveli prej 78% i angazhimit të FRESSH në fushatën e PS”, thuhet në raport. Megjithatë, pavarësisht angazhimit të ulët të mbështetësve në fushatë, efienca tyre në arritjen e rezultatit përfundimtar për zgjedhjeve rezultoi se ka qenë e mirë.

QARQET QË SHTUAN MANDATE

Qarqet që shtuan mandate deputetësh në krahasim me zgjedhjet e 2013-ës për PS ishin: Vlora, Durrësi dhe Tirana me nga 2 mandate secili dhe Fieri, Elbasani dhe Lezha me nga 1 mandat. Në aspektin e votës popullore Partia Socialiste në këto zgjedhje arriti të shtojë më shumë se 51 mijë vota më shumë se në zgjedhjet e kaluara politike pavarësisht faktit se në këto zgjedhje morën pjesë rreth 250 mijë votues më pak se në zgjedhjet e kaluara. “Vlerësim i potencialit elektorale të PS dhe përcaktim i objektivave për çdo OS ishte procesi që parapriu fushatën elektorale të Partisë Socialiste në zgjedhjet e 2017-ës për Kuvendin e Shqipërisë. Projektimi i numrit të votave potencialisht të arritshme për çdo OS ishte gjithashtu pjesë e këtij procesi. Real-

Analiza, ja qarqet ku mbështetësit braktisën fushatën e PS-së

Në Durrës dhe Shkodër militantët u angazhuan në masën 85.6%-88.9%, në Dibër dhe Fier 48.0%-49.3%



Rekomandime për zgjedhjet e ardhshme

1. Uljen e fiktivitetit të strukturave dhe motivimin për aktivizim periodik të anëtarësisë..
2. Përveç raporteve ekzekutive që japin një pamje dhe vlerësim sintetik mbi organizimin e fushatës elektorale dhe rezultatet e arritura nga Partia Socialiste në qarqe, drejtuesit politikë të qarqeve së bashku me deputetët e zgjedhur duhet të angazhohen në vlerësimin analitik dhe analizën e detajuar të punës individuale të secilës prej strukturave dhe forumeve të PS në qarqet e tyre deri në nivel OS.
3. Përgatitja e një metodologjie me procedura standarde dhe të thjeshta për organizimin e elektorale e cila në themel adreson dy procese thelbësore të fushatës elektorale: patronazhimin dhe monitorimin e votimit.
4. Rritja e prezencës në komunitet e drejtuesve të forumeve të PS duhet të jetë në fokusin e drejtuesve të strukturave dhe forumeve të PS. Është i nevojshëm tejkalimi i perceptimit nga komuniteti i strukturave lokale të PS (por jo vetëm) si “zyra punësimi”.
5. Duke patur parasysh qasjet e reja elektorale të votuesve dhe nevojën për një lidhje të drejtpërdrejtë të strukturave të partisë me qytetarët dhe jo vetëm me votuesit socialist, është e domosdoshme ridimensionimi i strukturave me qëllim patronazhimin e të gjithë qytetarëve të lidhur me territorin ku banojnë fizikisht dhe jo më me qendrën e votimit.

izimi i objektivit elektorale u arrit në 6 qarqe: Berat, Durrës, Gjirokastër, Kukës, Lezhë dhe Vlorë. Nga 3,828 OS në të gjithë vendin vetëm 1,657 ose 43.3% prej tyre arritën objektivin elektorale të PS”, vijon raporti. Po

ashtu, puna për mbledhjen e votave të reja nga zgjedhësit të afërt me Partinë Socialiste që nuk kanë votuar në 2013 ose që votonin për herë të parë në 2017 raportohet të ketë qenë relativisht e mirë. Kryetarët e OS në raportimet

ANGAZHIMI I MBESHTETESVE NE FUSHATEN E PS	
Berat	65.3%
Dibër	48.0%
Durrës	88.9%
Elbasan	53.7%
Fier	49.3%
Gjirokastër	65.2%
Korçë	65.3%
Kukës	77.8%
Lezhë	76.4%
Shkodër	85.6%
Tiranë	53.2%
Vlorë	62.6%

Angazhimi

Ekspertët e Partisë Socialiste ka konstatuar një angazhim të dobët të mbështetësve të saj në fushatën për zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit. Sipas raportit kofidencial për zgjedhjet, në nivel kombëtar, vetëm 60 e mbështetësve të PS janë angazhuar në fushatë.



Objektivat

Sipas raportit, angazhimi i pakët i pushtetit lokal në fushatë, fenomenet si shumtimi i votës në këmbim të favoreve apo punësimi u shfaqën si barriera kryesore në mos arritjen e objektivave elektorale.



e tyre evidentojnë afërsisht 60 mijë vota të reja për PS nga këto dy grupime.

FAKTORI QË NDIKOI NEGATIVISHT


Sipas raportit, angazhimi i pakët i pushtetit lokal në

Vota e emigrantëve Ja si ndikuan emigrantët në zgjedhjet e qershorit

Sipas raportit të PS, Një drejtim tjetër i veprimtarisë elektorale të strukturave të partisë për arritjen e fitores në zgjedhje qe puna me emigrantët. Në zgjedhjet e 25 qershorit në prag të ditës së votimit kanë hyrë në Shqipëri 48568 persona, ose 1130 vetë më shumë se në zgjedhjet e vitit 2013. “Në Greqi e në Itali e kryesisht në disa rajone të tyre është arritur një përvojë e mirë në organizimin e strukturave të partisë dhe në këtë fushatë pati një ridimensionim të punës me emigrantët. Veprimtaria elektorale për këto struktura erdhi si vijim i punës për riorganizimin e strukturave, të cilat në këtë kuadër bashkëpunuan ngushtë me strukturat e partisë në bashkitë dhe njësitë administrative të vendit tonë”, thuhet në raport. Si rrjedhojë e kësaj pune intensive nga Greqia në votimet e 25 qershorit, në qarqet Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Elbasan, Fier, Berat, Tiranë erdhën më se 23000 emigrantë me 2500 – 4000 vetë nga çdo qark dhe afër 2000 të tjerë në qarqet e tjerë. “Shumica absolute e tyre votuan Partinë Socialiste, çka përbushi objektivin jo vetëm për pjesëmarrjen por sidomos për votën për PS. Në informacionin e hollësishëm të Finiqit theksohet se erdhën për votime 743 emigrantë dhe 680 prej tyre kanë votuar për PS. Edhe nga strukturat e partisë të Degës së PS Itali, kanë ardhur për të votuar afër 9000 emigrantë”, thuhet në raport.

fushatë, fenomene si premtimi i votës në këmbim të favoreve apo punësimi u shfaqën si barriera kryesore në mos arritjen e objektivave elektorale. Analiza post zgjedhore e disa qarqeve evidenton edhe një element tjetër si ai i nivelin të ulët të pjesëmarrjes. Mos zbatimi me përpikmëri i skemës së patronazhimit dhe indiferenca e një pjesë të anëtarësisë dhe strukturave

për takimet derë me derë me qytetarët, ka sjelle një mos njohje të mirë të terrenit në disa zona ose neglizhencë në përthithjen e votës socialiste. Edhe në këto zgjedhje u vërejt një dispozicioni i madh i votave të marra nga disa kryetar bashkish socialistë në zgjedhjet e vitit 2015 dhe votave të marra nga PS në këto bashki në zgjedhjet për kuvend (rasti i Bashkisë Has, etj).



Fituesit

Krerët e 44 degëve të Partisë Socialiste në nivel bashkie, sipas raportit të analizës së zgjedhjeve, kanë shënuar performancë pozitive në zgjedhjet e parlamentare të 25 Qershorit dhe për rrjedhojë pozitë e tyre janë të konsoliduara.

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Ndonëse për herë të parë pas dy dekadave, shqiptarët i besuan të qeverisë e vetme Shqipërinë, Partia Socialiste ka bërë një analizë shteruese të rezultatin të zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit, duke marrë si pikë reference rezultatin në zgjedhjet parlamentare të 2013. Në raportin e analizës janë identifikuar të gjitha zonat, sipas hartës së ndarjes së territoriale, ku Partia Socialiste ka marrë më pak vota se sa në zgjedhjet parlamentare të 2013. Në 16 bashki PS ka shënuar rënie në raport me zgjedhjet paraardhëse. Ndërkaq, Asambleja e Partisë Socialiste, në mbledhjen e fundit në muajin gusht, vendosi që nga data 15 shtator deri në 30 tetor të zhvilloheshin zgjedhjet në parti në nivel vendor. Sipas vendimit të Asamblesë, i siguruar nga Shqiptarja.com, krerët e strukturave socialiste në nivel vendor, të cilët në zonët e tyre kanë marrë një rezultat negativ, krahasuar me zgjedhjet e kaluara, nuk do të lejohen që të kandidojnë.

Ja krerët degëve të PS që 'digjen', 44 heronjtë e fitores

Lista e zezë, largohen krerët e degëve me rezultat negativ, ikin edhe kryetarët e 1480 organizatave

Vendimi është i vlefshëm për krerët e organizatave dhe këshillat socialiste të njësive administrative, por i njëjti standard do të ndiqet edhe për krerët e degëve të Partisë Socialiste, në momentin e zhvillimit të procesit zgjedhor.

KRERËT E DEGËVE

Shqiptarja.com publikon emrat e krerëve të degëve të PS, në të gjitha bashkitë me rezultat negativ, të cilët nuk do të konfirmohen për një mandat tjetër, për shkak të rezultatin larg objektit të përcaktuar nga drejtuesit e lartë të Partisë Socialiste. Konkretisht, sipas raportit që mban autorësinë e Fatmir Xhafajt, kanë performancë negative elektorale krerët e degëve të PS në katër bashki të Qarkut të Elbasanit si: Ardit Demiri kryetar i degës së PS Elbasan, Gëzim Salla kryetar i degës së PS Cërrik, Edurim Teqja kryetar i degës së PS Peqin si dhe Haxhi Çollaku kryetar i degës së PS Përrenjas. Gjithashtu, duke iu referuar raportit për zgjedhjet, me rezultat negativ rezultojnë kreu i degës së PS në Shkodër, Arvit Osja si dhe kreu i degës së Vaut të Dejës Kristian Shkreli. Pjesë e listës së drejtuesve me rezultat negativ janë edhe kreu i degës së PS Pustec, Jani Ago, kreu i degës së PS Devoll, Eroidi Begolli dhe kryetari i degës së PS në Kavajë. Ndërkaq, nëse të lartpërmendurit nuk kanë të drejtë të rikandidojnë, do të largohen automatikisht edhe krerët e 1480 organizatave socialiste, rezultati i të cilëve është larg objektivit të përcaktuar.

së PS në Shkodër, Arvit Osja si dhe kreu i degës së Vaut të Dejës Kristian Shkreli. Pjesë e listës së drejtuesve me rezultat negativ janë edhe kreu i degës së PS Pustec, Jani Ago, kreu i degës së PS Devoll, Eroidi Begolli dhe kryetari i degës së PS në Kavajë. Ndërkaq, nëse të lartpërmendurit nuk kanë të drejtë të rikandidojnë, do të largohen automatikisht edhe krerët e 1480 organizatave socialiste, rezultati i të cilëve është larg objektivit të përcaktuar.

KRYETARËT ME REZULTAT POZITIV

Krerët e 44 degëve të Partisë Socialiste në nivel bashkie, sipas raportit të analizës së zgjedhjeve, kanë shënuar performancë pozitive në zgjedhjet e parlamentare të 25 Qershorit dhe për rrjedhojë pozitë e tyre janë të konsoliduara. Rezultatit më të thellë e kanë shënuar dega e PS në Krujë, me kryetar Ilir Loci, me 4,127 vota plus në krahasim me rezultatit në zgjedhjet e 2013, dega e PS në Divjakë, me kryetar Agim Maka, me 3,208 plus, dega e PS Kukës, me kryetar Erion Duraku, me 4,931 vota plus, dega e PS në Vlorë me 4,340 vota plus, dega e PS në Tiranë, e cila është drejtuar nga Saimir Tahiri, me 5,181 vota plus etj.

KRERËT E DEGËVE TË PS ME PERFORMANCË POZITIVE NË ZGJEDHJET E QERSHORIT

Valbona Zylyftari	dega e PS Berat	2,185 vota plus
Arshin Tusha	dega e PS Poliçan	850 vota plus
Arjan Çepele	dega e PS Ura Vajgurore	157 vota plus
Lefter Alla	dega e PS Bulqizë	327 vota plus
Bashkim Dardha	dega e PS Klos	160 vota plus
Hasan Pasha	dega e PS Mat	680 vota plus
Luan Zaza	dega e PS Durrës	5,531 vota plus
Ilir Loci	dega e PS Krujë	4,127 vota plus
Elton Arbana	dega e PS Shijak	1,726 vota plus
Marenglen Bali	dega e PS Belsh	666 vota plus
Klodian Taçe	dega e PS Gramsh	259 vota plus
Agim Maka	dega e PS Divjakë	3,208 vota plus
Gentiana Carkani	dega e PS Fier	4,992 vota plus
Lindita Buxhali	dega e PS Lushnjë	4,131 vota plus
Brarime Isufaj	dega e PS Mallakastër	460 vota plus
Klajdi Alisinani	dega e PS Patos	1,436 vota plus
Maksim Goga	dega e PS Roskovec	1,479 vota plus
Dhimitër Tolis	dega e PS Dropull	552 vota plus
Flamur Golemi	dega e PS Gjirokastrë	763 vota plus
Arnisa Ibrahim	dega e PS Libohovë	552 vota plus
Edmonda Harizi	dega e PS Memaliaj	97 vota plus
Adelina Janollari	dega e PS Përmet	161 vota plus
Arben Gumeni	dega e PS Tepelenë	398 vota plus
Ilirjan Hyseni	dega e PS Kolonjë	182 vota plus
Emiljano Muharremi	dega e PS Korçë	761 vota plus
Ornild Demollari	dega e PS Maliq	849 vota plus
Mira Dauti	dega e PS Has	823 vota plus
Erion Duraku	dega e PS Kukës	4,931 vota plus
	Tropojë	1,248 vota plus
Agron Ivani	dega e PS Kurbin	1,263 vota plus
Ardiana Jaku	dega e PS Lezhë	1,584 vota plus
Pjetër Pjetri	dega e PS Mirditë	966 vota plus
	Fushë-Arrëz	1,088 vota plus
Lulzim Zaraj	PS Malësi e Madhe	729 vota plus
Marash Kolaj	dega e PS Pukë	2,447 vota plus
Saimir Tahiri	dega e PS Tiranë	5,181 vota plus
Hekuran Brahimaj	dega e PS Vorë	273 vota plus
Brunilda Melqei	dega e PS Delvinë	251 vota plus
	Himarë	747 vota plus
Hristo Mallanezo	dega e PS Konispol	13 vota plus
Vnagjel Kaçi	dega e PS Finiq	986 vota plus
Jonida Abdul	dega e PS Sarandë	1,767 vota plus
Nertil Bellaj	dega e PS Selenicë	928 vota plus
Anduel Tahiraj	dega e PS Vlorë	4,340 vota plus

KRERËT E DEGËVE TË PS QË NUK E ARRITËN OBJEKTIN NË ZGJEDHJE

1.	Dega e PS Elbasan	Ardit Demiri,	minus 288 vota
2.	Dega e PS Cërrik	Gëzim Salla	minus 1,162 vota
3.	Dega e PS Peqin	Edurim Teqja	minus 2,957 vota
4.	Dega e PS Përrenjas	Haxhi Çollaku	minus 485 vota
5.	Dega e PS Shkodër	Arvit Osja	minus 2,285 vota
6.	Dega e PS Vau i Dejës	Kristian Shkreli	minus 547 vota
7.	Dega e PS Pogradec	Bledi Çomo	minus 1,524 vota
8.	Dega e PS Pustec	Jani Ago	minus 127 vota
9.	Dega e PS Devoll	Eroidi Begolli	minus 2,340 vota
10.	Dega e PS Kuçovë	Sybi Shehu	minus 465 vota
11.	Dega e PS Skrapar	Edmond Omeri	minus 226 vota
12.	Dega e PS Dibër	Afrim Mikli	minus 1,452 vota
13.	Dega e PS Këlcyre	Hodjan Selmani	minus 387 vota
14.	Dega e PS Kavajë		minus 1,939 vota
15.	Dega e PS Kamëz		minus 353 vota
16.	Dega e PS Rrogozhinë	Haxhi Memolla	minus 477 vota

Penalizimi

Shqiptarja.com publikon emrat e krerëve të degëve të PS, në të gjitha bashkitë me rezultat negativ, të cilët nuk do të konfirmohen për një mandat tjetër, për shkak të rezultatin larg objektit të përcaktuar nga drejtuesit e lartë të Partisë Socialiste.



Shqipëri-Britani, skuadër për hetimin e krimit

Zyrtari britanik takon ministrin
Fatmir Xhafaj. Propozimet e qeverisë
britanike për atë shqiptare



KRISTI GONGO
TIRANE

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj zhvilloi një takim ditën e djeshme me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Jashtme dhe kreun e Shërbimit Diplomatik të Mbretërisë së Bashkuar, Simon McDonald, i cili shoqërohej nga ambasadori Britanik në Tiranë, Duncan Norman. Në fokusin e këtij takimi ishte krijimi i skuadrave të përbashkëta policore për hetimin e përbashkët lidhur me grupet kriminale që veprojnë në të dy vendet dhe u ra dakord për konkretizimin shumë shpejt të këtij projekti në nivel teknikësh. Ministrin Xhafaj iu dorëzua edhe një letër e autoriteteve britanike përmes së cilës i shprehnin urimet për riemërimin si Ministër i Brendshëm, shoqëruar gjithashtu me vlerësimet për marrëdhënien produktive gjatë mandatit të tij të parë si Ministër i Punëve të Brendshme, duke shprehur sigurinë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh me qeverinë e re, të dalë nga zgjedhjet e 25 Qershorit. “Besojmë se kemi hedhur farën e një partneriteti të dobishëm për të dy palët në një sërë fushash që kanë të bëjnë me sigurinë. Një mandat i ri për partinë tuaj, së bashku me një mandat të ri për ju personalisht si Ministër i Brendshëm, do të bëjnë të mundur që ky partneritet të rritet më tej”, citohet ndër të tjera në letër.

PROPOZIMET E QEVERISË BRITANIKE

Gjithashtu, në letër përcillen propozime konkrete të qeverisë britanike për të ndërtuar një bashkëpunim efikas në fushën e luftës së krimit si dhe për mbështetjen konkrete që do t'i ofrohet Ministrisë së Brendshme në fushën e ndërtimit të kapaciteteve për Policinë e Shtetit, veçanërisht ndaj asaj kufitare, ofrimin e ekspertizës akademike për Akademinë e Sigurisë, si dhe mbështetje nga Kolegji i Policisë së Mbretërisë së Bashkuar. Pala britanike, theksoi se gjatë muajve të verës “ka hartuar një paketë gjithëpërfshirëse mbështetje, e cila do të përmbushë këto kërkesa. Ne besojmë se ajo përcakton balancën midis masave

TAKIMI

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj zhvilloi një takim dje me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Jashtme dhe kreun e Shërbimit Diplomatik të Mbretërisë së Bashkuar, Simon McDonald, i cili shoqërohej nga ambasadori Britanik në Tiranë, Duncan Norman. Në takim u diskutua edhe për krijimin e skuadrave të përbashkëta policore për hetimin e përbashkët lidhur me grupet kriminale.

afat-shkurtra, masave për rritje kapacitetshe dhe strategjive afatgjata parandaluese. Paketa pasqyron angazhimin tonë ndaj Shqipërisë dhe marrëdhënies tona dypalëshe:

Mbretëria e Bashkuar qëndron përkrah Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar”. Në takim u trajtuan gjithashtu edhe një sërë çështjesh, që kanë të bëjnë me trafi-

kimin e lëndëve narkotike dhe qenieve njerëzore (veçanërisht minorenëve), çështja e azilkërkuesve shqiptarë në territorin e Mbretërisë së Bashkuar, përmirësimi i regjimit kufitar shqiptar për parandalimin e azilkërkimit, ndërtimi i kapaciteteve të Policisë shqiptare, shkëmbimi i informacionit, hetimet e përbashkëta, ekspertiza akademike që pala britanike mund të ofrojë për Akademinë e Sigurisë etj. Pala britanike u shpreh e gatshme për të intensifikuar bashkëpunimin dhe mbështetjen për të gjitha fushat e sipërpërmendura

PROPOZIMET BRITANIKE

Propozimet konkrete të qeverisë britanike janë për të ndërtuar një bashkëpunim efikas në fushën e luftës së krimit si dhe për mbështetjen konkrete që do t'i ofrohet Ministrisë së Brendshme në fushën e ndërtimit të kapaciteteve për Policinë e Shtetit, veçanërisht ndaj asaj kufitare.

përmes asistencës teknike dhe mbështetjes me logjistike për rritjen e mjetshme të kapaciteteve të strukturave të Ministrisë dhe atyre të Policisë së Shtetit.

Në fund të takimit, McDonald njoftoi ministrin shqiptar

se vitin që vjen Britania e Madhe do të jetë vend pritës i Samitit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Nga të dy palët u shpreh gatishmëria për të prezantuar në këtë takim hapa dhe rezultate konkrete në bashkëpunimin midis tyre.

Ministri Gjiknuri pezullon veprimtarinë e “policëve gri”

Ristrukturimi i Ministrive, shkelja
e rregullores për kontrollet

Ministri i sapoemëruar i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjicknuri ka pezulluar ditën e djeshme veprimtarinë e ‘policëve gri’. Të gjitha kontrollet në rrugë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor nuk do të zhvillohen më, njofton Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Sipas ministrisë kontrollet bëhen në mënyrë të rastësishme duke mos respektuar rregulloren çka vë në rrezik jetën e drejtuesve të mjeteve. Ndër të tjera, në urdhrin e lëshuar nga ministria, theksohet se kontrolli ka shpesh mbivendosje me kontrollin e ushtruar nga organet e tjera të siç janë shërbimet e Policisë Rrugore dhe organet tatimore, duke sjellë shqetësime dhe pengesa në punën e operatorëve të transportit, deri në abuzime ndaj tyre dhe shkelje të sigurisë rrugore. “Aktualisht, kontrolli në rrugë ushtrohet në vende rastësore nga strukturat përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor edhe pse rregullorja referon që kontrolli ushtrohet në vende të posaçme, të përcaktuara me Udhëzim. Ushtrimi i kontrollit në vende të papërshtatshme paraqet rrezikshmëri, jo vetëm për jetën dhe shëndetin e drejtuesve të mjeteve që qarkullojnë në rrugë, por edhe për atë të kontrollorëve të rrugëve”, njofton Ministria. Pezullimi i veprimtarisë së kontrollit në rrugë do të bëhet deri në ristrukturimin e këtij institucioni dhe miratimin e ndry-



RISTRUKTURIMI


Ministri i sapoemëruar i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjicknuri ka pezulluar ditën e djeshme veprimtarinë e ‘policëve gri’. Të gjitha kontrollet në rrugë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor nuk do të zhvillohen më, njofton Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

shimeve të nevojshme. Pezullimi i asaj që njihet si “policia gri” u paralajmërua edhe dje nga kryeministri, Edi Rama, gjatë një interviste televizive.

BIENALJA E ÇIKAGOS

Kryebashkiaku Erion Veliaj prezanton sheshin “Skënderbej”

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ndodhet për një vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Veliaj ka prezantuar sheshin “Skënderbej” në bienalën e Çikagos, si dhe ka zhvilluar një takim me kryebashkiakun e Çikagos, Rahm Emanuel. Lajmin e ka bërë të ditur vetë kryebashkiaku Veliaj në rrjetin social Twitter, ku ndër të tjera falënderon kryebashkiakun e Çikagos për mikpritjen e lartë. “I kënaqur për hapjen e pavionit të sheshit “Skënderbej”, në bienalën në Çikago. Faleminderit kryetari Rahm Emanuel për mikpritjen e lartë”, shkruan Veliaj.



KËRCËNIMI I KORESË SË VERIUT

Ministri Ditmir Bushati: Cënim i sigurisë globale


Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë, Ditmir Bushati me anë të një njoftimi për mediat ka dënuar lëshimin e raketës balistike me rreze të mesme nga Republika Popullore Demokratike e Koresë. “Kjo shkelje e hapur, e përsëritur, e të drejtës ndërkombëtare dhe e rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së tregojnë se regjimi koreanoverior është i vendosur të vazhdojë të sfidojë komunitetin ndërkombëtar duke përshkallëzuar më tej tensionin në rajon dhe kërcënuar në mënyrë serioze sigurinë globale. Qeveria shqiptare i



bën thirrje RDPK të ndalojë menjëherë provokimet dhe të kthehet në tryezën e bisedimeve si rruga e vetme për një zgjidhje paqësore dhe të qëndrueshme në gadishullin Korean”, thuhet në njoftimin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Kërkesa

Partia Demokratike ka nisur punën për Reformën Zgjedhore. Gjatë mbledhjes së kryesisë së grupit parlamentar të Partisë Demokratike, është vendosur që të depozitohet të hënën në Kuvend, kërkesa për ngritjen e komisionit “ad hoc” parlamentar për reformën zgjedhore.



Ndryshimi i orarit

“Deputetët do funksionojnë ndryshe. Puna e deputetëve është full-time, jo me kohë të pjesshme. Disiplinim i punës, për të arritur efikasitetin dhe opozitarizmin. Nuk mund të lejohen më angazhime të pjesshme me disa orë. Deputetët do të angazhohen çdo ditë me kohë të plotë si ligjvënës dhe në shërbim të qytetarëve”.

BASHA PËR DEPUTETËT: JENI FULL-TIME

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha në mbledhjen e Kryesisë ditën e djeshme, përveç diskutimit për vendimet ka dhënë edhe disa porosi për deputetët e rinj. Burime të Report Tv bëjnë me dije se Basha iu ka kërkuar deputetëve të punojnë me kohë të plotë, duke thënë se s'ka më angazhime të pjesshme. Më tej, kreu demokrat mësohet se ka kërkuar të caktohen datat dhe kalendarët për mbledhjen dhe përgatitjen e të gjithë deputetëve për ligjet dhe oponencën në Parlament dhe në publik, si dhe ditët e takimeve me qytetarët në zonat elektorale. “Deputetët do funksionojnë ndryshe. Puna e deputetëve është full-time, jo me kohë të pjesshme. Disiplinim i punës, për të arritur efikasitetin dhe opozitarizmin. Nuk mund të lejohen më angazhime të pjesshme me disa orë. Deputetët do të angazhohen çdo ditë me kohë të plotë si ligjvënës dhe në shërbim të qytetarëve. Caktohen ditët e kalendarët për mbledhjen dhe përgatitjen e deputetëve për ligjet dhe oponencën në Parlament dhe në publik, si dhe ditët e takimit me qytetarët në zonat elektorale. Të gjithë deputetët aktivë, asnjë i mënjanojnë”, mësohet t’i u ketë thënë Basha deputetëve demokratë.

PD: Të ngrihet komision për votimin elektronik

Kërkesa për Kuvendin depozitohet të hënën. Basha u ndryshon oraret deputetëve: Jeni full-time

Partia Demokratike i kërkon Partisë Socialiste që të nisin që tani punën për Reformën Zgjedhore. Gjatë mbledhjes së kryesisë së grupit parlamentar të Partisë Demokratike, është vendosur që të depozitohet të hënën në Kuvend, kërkesa për ngritjen e komisionit “ad hoc” parlamentar për reformën zgjedhore. Në fokus të mbledhjes së djeshme, kanë qenë dy pika thelbësore, të cilat lidhen me problematikat e zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit, konkretisht për shitblerjen dhe manipulimin e votës siç pretendon Partia Demokratike, si dhe për votimin elektronik. PD kërkon që në zgjedhjet e ardhshme shqiptarët të votojnë në mënyrë elektronike, gjë që sipas kryetarit të kësaj force politike, Lulzim Bashës do të shmangte manipulimin e votave. Reforma Zgjedhore ishte tema e debatit mes shumicës dhe opozitës në fund të mandatit të kaluar, pasi PD kërkonte me çdo kusht votim elektronik. Kjo ishte dhe arsyeja e hapjes së ‘çadërës së lirisë’ nga PD, e cila zgjati më shumë se një muaj. Por një gjë e tillë sipas shumicës ishte e pamundur, pasi nuk kishte kohë të mjaftueshme për ta realizuar. Ndërsa me fillimin e legjislaturës së re të Kuvendit, PD e ka në plan të parë realizimin e këtij objekti. Këtë ka deklaruar edhe Lulzim Basha, në fjalën e tij të parë si kryetar i opozitës në Kuvend, pak ditë më parë. Basha ka akuzuar se në 25 qershor ka pasur shitblerje

masive të votave, pavarësisht se ishte pjesë e qeverisë me ministrat teknikë dhe zv/kryeministrin. Ashtu si në komisionin e parë, edhe këtë herë nga PD përfaqësues do të jetë Oerd Bylykbashi. Kujtojmë që Reforma Zgjedhore ishte një nga pikat e paktit mes Ramës dhe Bashës në 17 Maj, por lideri demokrat deklaroi në Kuvend pak ditë më parë se ajo marrëveshje ka vdekur.

Tashmë mbetet për t’u parë nëse do të ketë konsensus mes palëve për Reformën Zgjedhore, por edhe pikat e tjera.

PALOKA: DO I KËRKOJMË LLOGARI QEVERISË SË RE

Kërkesa e Partisë Demokratike drejtuar Kuvendit për reformën zgjedhore, është konfirmuar edhe nga nënkryetari i Parlamentit, Edi Paloka, jashtë dyerve të selisë blu në fund të

mbledhjes. Paloka tha se do të bëhet menjëherë kërkesa për ngritjen e një komisioni ad-hoc për reformën zgjedhore. “Menjëherë do të bëjmë kërkesën për ngritjen e një komisioni ad-hoc për reformën zgjedhore. Një komision, i cili ndër të tjera do të ketë si pikë kryesore apo të rëndësishme votimin dhe numërimin elektronik”, tha Paloka. Gjithashtu, Paloka ka zbuluar se në mbledhjen e

Kryesisë me dyer të mbyllura është rënë dakord që të thirren disa prej ministrave dhe të kërkohet informacion lidhur me strukturën e re të qeverisë. “Ramë dakord që të thirren disa prej ministrave dhe të kërkohet informacion lidhur me strukturën e re të qeverisë, e cila duket qartazi që nuk është një strukturë që është ngritur për të funksionuar mirë qeveria”, përfundoi nënkryetari i PD.

TAKIMI ME PACOLLIN/ BERISHA: PRIORITET HEKURUDHA MILOT – PRIZREN

Basha: Integrimi e interesi kombëtar shtyllat e PD

Zëvendëskryeministri dhe njëkohësisht Ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë vizitës dy ditore në Shqipëri ka zhvilluar një takim edhe me ish-kryeministrin Sali Berisha dhe kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha.

Sipas njoftimit të zyrës së shtypit të PD, Basha siguroi Pacollin se Partia Demokratike do të jetë në mbështetje dhe në bashkëpunim të plotë me qeverinë e re të Kosovës. Më pas Basha bëri një panoramë të zhvillimeve politike në Shqipëri, ku vuri theksin

te nevoja jetike për stabilitetin dhe të ardhmen europiane të vendit, ku me rëndësi kyçe janë zgjedhjet e lira e të ndershme. Basha theksoi se për Partinë Demokratike, integrimi europian dhe interesi kombëtar do të jenë shtyllat kryesore të çdo qëndrimi të PD-së. Gjithashtu kryetari i PD, Basha u shpreh se mbështet dhe nxit integrim sa më të thellë mes Shqipërisë dhe Kosovës, në këtë kuadër përshëndet vullnetin për bashkim doganor, por theksoi se kjo bëhet me një angazhim të thellë e të plotë dhe jo sipërfaqësor. Ndërsa ish-kryeministri, Sali Berisha në një status në Facebook shkruan se prioritet duhet të jetë hekurudha Milot-Prizren, e cila është jetike për Kosovën por dhe për rajonin në tërësi. Sipas Berishës, së bashku me autostradën, hekurudha e bën Kosovën vend me porte të vetat. “Në këtë kuadër theksova se përparësi me të madhe duhet të marri hekurudha Milot -



Prizren, e cila është jetike për Kosovën por dhe për rajonin në tërësi. Ndërtimi hekurudhës do të plotësonte korridorin më vizibël të rajonit dhe natyrisht kjo edhe për Shqipërinë dhe

për Kosovën do kishte një interes të jashtëzakonshëm. Së bashku me autostradën, hekurudha e bën Kosovën vend me porte të vetat. Theksova se duhet të punohet në mënyrë

Takimi

Zëvendëskryeministri dhe njëkohësisht Ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë vizitës dy ditore në Shqipëri ka zhvilluar një takim edhe me ish-kryeministrin Sali Berisha dhe kryetarin e PD, Bashën.

STUDIO PERMBARIMORE “SHKRELA” DO TË ZHVILLOJE ANKANDIN E PARË PËR PASURITË:

a) “Apartment”, me sipërfaqe totale 77.36 m², me nr. Pasurie 6/121+1-2, e ndodhur në zonën kadastrale Nr. 8534, Volumi 5, Faqe 138, e ndodhur në Lagjia 16 Prilli, Fier, në pronësi të Vasillaq Tefi Zhaka.

Cmimi me të cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 22,898.4 (njetete e dy mije e teteqind e nentendhjetë e tete pike kater) Euro.

b) “Apartment”, me sipërfaqe totale 62.2 m², me nr. Pasurie 6/121+1-4, e ndodhur në zonën kadastrale Nr. 8534, Volumi 5, Faqe 140, e ndodhur në Lagjia 16 Prilli, Fier, në pronësi të Vasillaq Tefi Zhaka.

Cmimi me të cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 18,411.2 (tetendhjetë mije e katerqind e njembendhjetë pike dy) Euro.

c) “Apartment”, me sipërfaqe totale 74 m², me nr. Pasurie 6/36+1-4, e ndodhur në zonën kadastrale Nr. 8534, Volumi 6, Faqe 148, e ndodhur në Lagjia 16 Prilli, Fier, në bashkëpronësi të Vasillaq Tefi Zhaka dhe Lefteri Vangjel Zhaka dhe Lefteri Vangjel Zhaka.

Cmimi me të cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 21,904 (njetete e nje mije e nenteqind e kater) Euro.

d) “Apartment”, me sipërfaqe totale 51 m², me nr. Pasurie 116/71+1-31, e ndodhur në zonën kadastrale Nr. 2291, Volumi 29, Faqe 174, e ndodhur në Kryemedhenj, Kavaje, në pronësi të Vasillaq Tefi Zhaka.

Cmimi me të cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 19,200 (nentendhjetë mije e dyqind) Euro.

Pasuritë janë në bashkëpronësi të Vasillaq Zhaka dhe Lefteri Zhaka dhe të hipotekuara në favor të bankës.

Ankandi i parë zhvillohet me date 20.09.2017, ora 16.00 në ambientet e Studios Permbarimore Shkrela me Adrese:Rruga Blv.Zogu i I, Pall. “Agimi”, H 2, K 3, Ap. 5, Tiranë.

Mblidhet KLD, Meta: Vullnet për zbatimin e ligjit të Vettingut

Këshilli mblidhet për Vettingun dhe dhunën në familje. Vrasja e Rukos, inspektim për gjyqtarin e Fierit


Eshtë zhvilluar dhe mbledhja e pare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në drejtimin e Presidentit Ilir Meta. Mbledhja ka zgjatur për rreth 2 orë, ndërsa mungonin tre anëtarë, dy prej të cilëve janë zgjedhur në organet e reja të drejtësisë. Në mbledhje u diskutua për shqetësimin e gjyqtarëve për procesin e rivlerësimit dhe dhunën ndaj grave, nisur nga vrasja e gjyqtarës Fildez Hafizi. Këshilli shprehu gatishmërinë për të dhënë kontributin e tij brenda kornizës ligjore në fuqi në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm i Apelimit, me qëllim përshtetimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Në përfundim të mbledhjes Presidenti Ilir Meta deklaroi për mediat se ka vullnet për të bashkëpunuar me institucionet e reja të drejtësisë që po ngrihen. “Mbledhja përfundoi me një kohë të shpejtë, që do të thotë se vullneti për bashkëpunim, për të plotësuar të gjitha detyrimet që ka ky institucion deri në krijimin e institucioneve të reja kushtetuese është maksimal dhe në kuadër të përshtetimit të

Verifikimet

Vrasja e Liliana Rukos, KLD-ja inspektim për gjyqtarin e Fierit

Dy pika të rëndësishme të rendit të ditës ishin edhe rasti i vrasjes së gjyqtarës Fildez Hafizi nga burri pak ditë më parë dhe urdhrat e mbrojtjes. KLD me urdhrë të presidentit Meta ka nisur një procedurë verifikimi për vendimin e marrë më 28 prill 2016 nga Gjykata e Kavajës ndaj Fadil Kasemit, por edhe vrasjes së Liljana Rukos në Fier vitin e kaluar. Anëtarët e Këshillit pasi shqyrtuan informacionin e ardhur nga Inspektorati, vendosën që në mbledhjen më të afërt të analizojnë informacionin që i është kërkuar Gjykatave nën juridiksionin e KLD-së në lidhje me çështjet që lidhen me fenomenin shqetësues të dhunës në familje. Bazuar në përcaktimet e rendit të ditës, anëtarët e KLD-së

shqyrtuan raportin e Ministrisë së Drejtësisë mbi kryerjen e hetimit administrativ për verifikimin e procedurave të lëshimit të urdhrat të mbrojtjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për Liljana Rukon. Për rastin në fjalë, Këshilli vendosi të kryejë një inspektim tematik për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, E.S. Ndërsa, Gerd Hoxha u shpreh sot se KLD vendosi që të ketë një inspektim në të gjitha gjykatat e vendit për këtë tematikë dhe në mbledhjen e ardhshme do të vendoset. “Raporti për dhunën në familje, inspektim tematik për të gjitha gjykatat e vendit, në mbledhjen e radhës do të vendoset” deklaroi ai. Pas vrasjes së Fildez Hafizit nga bashkëshorti, Meta deklaroi para



Hoxha:

KLD ndihmë komisioneve për vlerësimin e gjyqtarëve



Pas mbledhjes ka folur për mediat edhe gjyqtari Gerd Hoxha, kryetari i Bordit Drejtues të Unionit të Gjyqtarëve. Hoxha theksoi se KLD diskutoi për shqetësimin e gjyqtarëve për procesin e rivlerësimit, ndërsa sipas tij shprehu gatishmëri për të dhënë ndihmesën e saj për komisionet. “Nën drejtimin e Presidenti, KLD diskutoi një relacion të përgatitur nga Inspektorati. KLD shprehu gatishmëri për pikë kontakti për të dhënë ndihmesën e tij për të përgatitur aktet e duhura për të rregulluar modalitetet. KLD në këtë moment tranazicioni, shpreh gatishmëri për të dhënë ndihmën për komisionet, që procesi i vlerësimit të gjyqtarëve të vijojë sa më shpejt dhe shqiptarët do të ndihen më të mirë dhe gjyqtarët më të lirë nga presioni. Fushë e pashkelur si duhet përgatitur, KLD ka përgatitur si mund të veprojë me testimin e gjyqtarëve, koha e vlerësimit, mënyra dhe gjërat e tjera” deklaroi ai.

zbatimit të reformës në drejtësi dhe sidomos të zbatimit të ligjit të Vetting-ut, por njëkohësisht edhe në drejtim të përbashkimit të sfidave që ka funksionimi aktual

i sistemit gjyqësor, që natyrisht ka vështirësitë e veta drejt kalimit në një sistem plotësisht të ri. Cilat ishin shqetësimet e KLD-së në lidhje me Vetting-un?

“Unë besoj se këto do të bëhen publike, sepse diskutimet në KLD-së bëhen publike, por natyrisht që ky është një proces plotësisht dhe vullneti është maksimal për të

bashkëpunuar me institucionet e reja të Vetting-ut, por edhe me EURALIUS dhe OPDAT-in që asistojnë në këtë proces” deklaroi ai.

Komiteti Ushtarak i NATO-s në Tiranë, vijnë 38 delegacione

Presidenti Meta takon komandantin e Ushtrisë së SHBA

Shefat e Shtabeve të vendeve anëtare të NATO-s po zhvillojnë në Tiranë, përgjatë dy ditëve (15-17 shtator), Komitetin Ushtarak të kësaj aleance, ku marrin pjesë 38 delegacione. Komiteti do të kryesohet nga komandanti Suprem i Forcave Aleate për Europën, gjeneralin Curtis M. Scaparrotti dhe kryetari i

Komitetit Ushtarak të NATO-s, gjeneral Petr Pavel. Krerët e ushtrive të vendeve anëtare të NATO-s, do të diskutojnë për situatën e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si dhe do të japin rekomandime për vazhdimësinë e misionit ‘Resolute Support në Afganistan’ dhe KFOR Kosovë. Gjithashtu, ata do të zgjedhin kryetarin e ardhshëm të Komitetit Ushtarak të NATO-s, i cili do të marrë detyrën në verën e vitit 2018. Përpara nisjes së punimeve të Komitetit, krerët e NATO-s kanë zhvilluar takime me presidentin Ilir Meta dhe ministrin e Mbrojtjes, Olta Xhaçka.

NDIHMË PËR FA, E ÇMUAR

Presidenti Ilir Meta ka prituri në një takim të veçantë Shefin e Shtabeve të Bashkuara të SHBA-ve, Gjeneralin Josph Dunford, njofton zyra e shtypit të Presidencës. Sipas komu-

nikatës për shtyp, “presidenti Meta ka vlerësuar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si të një rëndësie parësore dhe strategjike dhe bashkëpunimin në kuadër të NATO-s, përballë sfidave të përbashkëta globale si lufta kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm e qëndrueshmëria e sigurisë në rajon”. “Meta i shprehu mirënjohjen për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që SHBA i ka dhënë Forcave tonë të Armatosura në procesin e tyre të transformimit dhe modernizimit duke nënvizuar edhe ndihmën e fundit me mjete speciale transporti të blinduara. Meta ka shprehur mirënjohje për mbështetjen e SHBA në realizimin e reformave të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, transformimin dhe rritjen e kapaciteteve operacionale dhe edukimin e Forcave të Armatosura, mbështetjen e institucioneve të inteligjencës, rolin përcaktues



të SHBA-së në çlirimin e Kosovës dhe angazhimin e tyre në sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë të Ballkanit dhe mbështetjen kritike për anëtarësimin në NATO”, shkruhet në deklaratën e shpërndarë për mediat. Gjatë bisedimeve, Gjenerali Dunford falenderoi Presidentin Meta për angazhimin dhe kontributin e Shqipërisë dhe Forcave të saj të Armatosura përkrah ushtrisë së SHBA-së në Afganistan, Irak, dhe vende të tjera dhe vlerësoi përpjekjet e Shqipërisë për ngritjen e nivelit të partneritetit dhe të koordinimit strategjik Shqipëri-SHBA, thuhet në deklaratë.

MINISTRJA E MBROJTJES

Xhaçka takim me krerët e NATO: Shtojmë forcat në Afganistan

Në kuadër të takimit të shefave të Shtabeve të vendeve anëtare të NATO-s, i cili po zhvillohet në Tiranë në datat 15-17 shtator, ministrja e re e Mbrojtjes Olta Xhaçka, ka prituri dje në takime komandantin Suprem të Forcave Aleate për Europën, gjeneralin Curtis M. Scaparrotti dhe kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, gjeneral Petr Pavel. Sipas një komunikate për shtyp nga zyra e shtypit të Ministrisë së Mbrojtjes, “në takimin me komandantin Suprem të Forcave Aleate për Europën, gjeneralin Curtis M. Scaparrotti, ministrja Xhaçka e njohu ushtarakun e lartë me prioritetet e saj në krye të Ministrisë së Mbrojtjes, kryesisht modernizimin dhe stërvitjet. Gjithashtu znj.

Xhaçka i shprehu gjeneral Scaparrotti qëndrimin e palëkundur të vendit tonë në mbështetje të misioneve dhe operacioneve në kuadër të NATO-s. Në këtë kuadër, ministrja Xhaçka informoi ushtarakun e lartë me vullnetin e qeverisë shqiptare për



të shtuar me një togë numrin e ushtarakëve shqiptarë në misionin Resolute Support, në përgjigje të kërkesës së strategjisë së re të presidentit amerikan Donald Trump për Afganistanin”, shkruhet në komunikatë.

Porti i Bilbaos, porta e pasme e shqiptarëve për të hyrë në Angli

Mediat ndërkombëtare zbulojnë internerarin e ri të emigrantëve klandestinë

Nga Bilbao, në veri të Spanjës, në Portsmouth, në bordin e trageteve që transportojnë mallra të tonazhit të lartë, fshehur mes kamionëve TIR dhe kontejnerëve, në pritje të zbarkimit në Angli. Presioni i emigrantëve klandestinë në "rrugën atlantike" është rritur, sidomos pas çmontimit të kampit të refugjatëve në Kale, në bregun francez. Për shumë emigrantë në largim nga vendet e origjinës, rruga baske është gjithmonë e më tepër një alternativë më e mirë se itineraret e tjerë kontinentalë që kanë provuar. Është porta e pasme për të hyrë në Angli. Disa qindra emigrantë, të paktën 200, shumica shqiptarë, por edhe marokenë, algerianë, pakistanezë, irakenë apo sirianë, janë strehuar prej javësh në çadra të ngritura pranë gardhit rrethues të portit të Zierbenas, një qendër e vogël rreth 20 km nga Bilbao, nga ku çdo javë nisen e pakta tre tragete mallrash në drejtim të Poole apo Portsmouth, në jug të Anglisë. Presin momentin e duhur për t'u futur në TIR-ët e mëdhenj apo në kontejnerë,

të cilët shkojnë nga Gjiri i Biskajës në Angli.

Forcat e policisë spanjolle kanë interceptuar 119 klandestinë më 2015, 300 më 2016 dhe 1.346 që nga fillimi i këtij viti. Por ndërkaq, mijëra emigrantë kanë kaluar përmes kampit të ngritur me çadra në kushte ekstreme në Zierbena. Kompanitë e lundrimit denoncojnë dëmet e shkaktuara nga trafiku dhe rreziku që sjellin udhëtimet e shpresës për emigrantët. "Shumë tentojnë të qëndrojnë varur në akset e rimorkiove të TIR-ëve, duke rrezikuar jetën", thotë Manuel Pascual, i kompanisë Brittany Ferries Espaa, në një deklaratë për



gazetarët. Për çdo klandestin të kapur në traget, kompanitë detare duhet t'i paguajnë gjobë qeverisë britanike dhe të sigurojnë kthimin në pikën e nisjes. Por janë të shumtë ata që sapo kthehen në Bilbao riprovojnë sërish fatin.


Pjesa më e madhe e të rinjve në kampin në Zierbena janë të identifikuar dhe nuk sjellin probleme, sipas zëdhënësit të policisë spanjolle, Esteban Izquierdo. "Shumica janë shqiptarë dhe mund të qëndrojnë këtu, sepse nuk kanë nevojë për vizë në zonën Schengen. Por u duhet për të zbarkuar në Britaninë e Madhe". Shumica kthehen mbrapsht pasi arrijnë

në Angli. Nga 1.346 emigrantët e interceptuar nga fillimi i vitit, vetëm 55 arritën t'i shpëtonin policisë britanike, të tjerët u kthyen në Spanjë. Gjithsesi, mafia shqiptare po e përdor portin e Bilbaos si bazë për trafikun ilegal të qenieve njerëzore, sipas The Times, duke përfutur nga fakti që shqiptarët e parregullt janë përgjegjës për vetëm për "një shkelje të vogël administrative" në territorin evropian. Për kalimin deri në Portsmouth "u paguajnë deri në 2 mijë euro mafiozëve shqiptarë".

Edhe sot qindra qëndrojnë pranë portit në Zierbena dhe pyjet aty pranë, duke bërë roje me radhë për të njoftuar për ardhjen e patrullave të policisë. Për të frenuar trafikun, në një aksion të përbashkët midis autoriteteve portuale të Bilbaos, policisë baske e asaj kombëtare, gardës civile, kapitenerisë detare, doganës e prefekturës, janë forcuar kontrollet gjatë 24 orëve, edhe mbi tragete, me sensorë me dioksid karboni për të zbuluar praninë e njerëzve në kontejnerë. E megjithatë, deri tani nuk ka shërbyer për frenimin e fluksit në rritje në rrugën atlantike.

Sekuestrohen pasuritë e grabitësit që terrorizonte Spanjën

Tiranë, Prokuroria: Gjon Gjezaj investoi para me blerje pronash



Gjon Gjezaj

Grabiste vila dhe apartamente me grupin e tij në Spanjë, pas arrestimit në Shqipëri i bllokohen pasuritë me vendim gjykatë. 130 mijë euro të pajustificuara dhe një apartament në Tiranë në pronësi të Gjon Gjezaj njohur dhe me emrin Shkëlzen Gjezaj janë sekuestruar për llogari të procedimit penal pastrim parash dhe aktivitet kriminal jashtë vendit. Sipas prokurorisë Gjezaj kishte deklaruar blerjen e tre apartamenteve në Tiranë por realisht kishte blerë vetëm një në vlerën e 41.800 euro pasi dy kontratat

e tjera ishin bërë fiktivisht me një kompani ndërtimi e cila kishte falimentuar. Nga hetimi gjyqësor i fakteve ka rezultuar se Gjezaj është i arrestuar në Spanjë dhe ndodhet në paraburgim në kuadër të një operacioni realizuar në 2016 nga Roja Civile Spanjolle. Ky grup kryente grabitje me armë e dhunë në rajonet e Madrid,

Barcelonë dhe plazheve spanjolle dhe nga gjurmimi i tyre nga autoritetet spanjolle ka rezultuar se paratë i sillnin në Shqipëri duke i investuar në blerje pasurie.

Operacioni asokohe u kodua "Kruja" pasi pjesa më e madhe e grabitësive përfshi dhe Gjezën janë me origjinë nga Kruja.



MALËSIA E MADHE

Vermosh, IKMT prish shtëpinë e heroit, banorët në protestë

Banorët e Vermoshit në Malësinë e Madhe janë ngritur në protestë ditën e sotme pasi Inspektorati Ndërtimor i Bashkisë ka prishur shtëpinë e heroit të Shkodrës, Prek Cali. Sipas banorëve ky është një turp kombëtarë. "Me shembjen e ndërtimit na kanë

vrarë për të dytën here! Nuk e kuptojmë kush e ka dhënë këtë urdhër!!! Turp kombëtar", janë shprehur banorët. Shembja e shtëpisë së heroit vjen me pretendimin se nuk ka leje ndërtimi, ndërsa ndërtimi i shtëpisë së Calit është bërë nga paratë e diasporës në Amerikë.

Dalin pamjet, grabitësi i kazinos, i qetë dhe me cigare

Tiranë, 30-vjeçari u arrestuar nga Policia e Tiranës

Drilon Niko, 30-vjeçari që grabiti një kazino mbrëmjen e së enjtes, është arrestuar nga Policia e Tiranës. Report TV ka siguruar videon kur Drilon Niko futet në brendësi të një kazinoje në Tiranë dhe kontrollon për lekët. Është ora 23:08:10 sekonda kur 30 vjeçari i afrohet banakut të kazinos. I veshur me një bluzë të kuqe, në dorën e djathtë mban një thikë, Niko



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

kontrollon sirtarët për lekë, ndërkohë që konsumon edhe një cigare. Për 40 sekonda Drilon Niko, kontrollon të gjithë sirtarët, arrin të marrë lekët që ndodhen në sirtarin e banakut dhe më pas largohet pa u shqetësuar nga askush. Bie në sy fakti se Drilon Niko ka qënë mjaft i qetë gjatë gjithë kohës kur ka kryer grabitjen dhe mendohet se më herët ka konsumuar lëndë. Më herët ai kishte kërcënuar me thikë punonjësin e kazinos dhe është larguar me shpejtësi. Por vetëm pas pak minutash policia e Tiranës e ka arrestuar 30-vjeçarin, pasi kishte marrë informacion për grabitjen. Drilon Niko akuzohet për dy vepra penale vjedhje me dhunë dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta.

Polici-hajdutit: Ik ore kap prokurorin se ike në kokërr të burgut

Si e njoftonte efektivi i "Shqiponjave" të kërkuar nga policia "...Je në sistem me Alert..."

ELTON QYNO
TIRANE

Në një kohë kur po flitet shumë për "Vetting" mes rradhëve të gjyqësorit dhe prokurorëve, është padiskutim e nevojshme që procesit të "Vetting" t'i nënshtrohet dhe efektivet e Policisë së Shtetit. Shumë prej tyre janë të lidhur me organizata kriminale, kontigjentë kriminalë dhe biznese të ndryshme në vend, ku përkundrejt një pagese të caktuar ata vihen në shërbim të këtyre komponentëve. Thuajse çdo muaj, policia e Shtetit njofton arrestimin e një efektivi policie, i cili është vënë në shërbim të eksponentëve kriminalë dhe përdor institucionin dhe uniformën e policit, duke i shërbyer kultivuesve të drogës dhe faktorëve të tjerë kriminalë. Shpesh herë ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj ka "kërcënuar" uniformat blu se do i nënshtrohen procesit të "vettingut", që siç e quan ai kjo gjë duhet të kryhet për të pastruar vetveten. Rasti i arrestimit të efektivit të policisë Engrid Hënaj, është rasti më tipik se pse duhet të kryhet me patjetër vettingu në rradhët e policisë. Nga përgjimet e kryera ka rezultuar se Hënaj, jo vetëm që sinjalizon për veprimet e policisë dhe prokurorisë një hajdut makinash, por e këshillon këtë të fundit që të shkojë dhe të takojë ose ti fusë njerëz prokurorit në mënyrë që dosja e tij të mbyllet. Efektivi i skuadrës "Shqiponja" në policinë e Tiranës, bashkëpunon ngushtë me personin e shpallur në kërkim Fatjon Lila, ky i fundit i akuzuar për akuzën e vjedhjes së automjeteve. Ndër të tjera polici e informon Lilën se në sistemin e brendshëm të policisë së Shtetit ai ishte në kërkim, pasi konfiguronte




Engrid Hënaj

me "ALERT". Gjithashtu punonjësi i policisë së shtetit informon dhe kërkon takim me një person tjetër, me pseudonimin "kapelja" që besohet se është shtetasi 29-vjeçar Xhordano Palushi. Palushi dhe Lala, janë arrestuar së bashku në 25 gusht 2017 gjatë operacionit të koduar "Summer 2017". Dy javë pas arrestimit të tyre, prokuroria e Kavajës në bashkëpunim edhe me SHÇBA Tiranë kanë bërë dy ditë më parë arrestimin e efektivit të policisë Engrid Hënaj, për akuzën e

"Shpërdorimit të detyrës". Sot gazeta "Shqiptarja.com" zbardh të plotë përgjimet e kryera nga prokuroria e Kavajës. Në bisedat e kryera evidentohet një bisedë ku polici i thotë hajdutit se duhet të shkojë të takojë prokurorin, se për ndryshe do shkonte në burg.

HETIMET DHE PËRGJIMET

Në datën 6 shtator 2017, nga ana e prokurorisë së Kavajës, është administruar informacioni i dërguar nga shërbimet e policisë në Drejtorinë e



SHÇBA Tiranë, sipas së cilës ka rezultuar se, akuzat e Tiranës ka në hetim punonjësin e policisë Engrid Hënaj. Në këtë informacion thuhet se nga tërësia e veprimeve hetimore kanë dalë të dhëna se ky punonjës policie herë pas here ka pasur komunikime të vazhdueshme me shtetasin Fatjon Lila, ky i fundit i akuzuar disa herë për vjedhje. Komunikimi mes shtetasit Fatjon Lila dhe punonjësit të policisë Engrid Hënaj është realizuar nëpërmjet numrave të telefonit celular 0675XXXX dhe 06975XXX, numra të cilët i dispononte efektivi i policisë Fatjon Lila. Prokuroria e Kavajës ka hetuar çështjen për veprën penale të parashikuar nga neni 134/2/3 të Kodit Penal dhe gjatë hetimeve paraprake është regjistruar emri i personit nën hetim Fatjon Lila si autor dhe në përfundim të hetimeve është vendosur dërgimi për gjykim me masë sigurimi "arrest në burg" në mungesë. Nga studimi i akteve të transkripteve të përgjigjeve telefonike rezulton se shtetasi Engrid Hënaj punonjës policie pranë Drejtorisë Vendore Policisë Tiranë, është i implikuar →

SHKURT

ARRESTIMI NË TIRANË

Policia gjen heroinë, armë e municione të kërkuar

Policia e Tiranës ka finalizuar mbrëmjen e kësaj të premte operacion policor të koduar "Silenciatori", me arrestimin e një 53-vjeçari i cili dyshohet si autor i një sulmi me armë ku është qëlluar automjeti i P.P. 5 ditë më parë në kryeqytet. Në prangat e policisë ka rënë Edmond Saraçi, banues në Tiranë pasi gjatë këtij operacioni,

blutë i kanë gjetur në banesë lëndë narkotike e dyshuar e llojit "heroinë", armë zjarri e llojit "pistoletë", me silenciator, lëndë eksplozive me kapsolle detonatore, granatë luftarake dhe municione. Sipas policisë, në datën 10.09.2017, Saraçi ka qëlluar në drejtim të automjetit në pronësi të P.P. në rrugën "Muhamet Deliu", në Tiranë.



OPRACIONI NË VLORË

Nëpër qytet me pistoletë në brez, pranga 39-vjeçarit

Një 39-vjeçar është arrestuar ditën e djeshme nga policia në Vlorë, pasi ju gjet një pistoletë pa leje. Sipas policisë 39-vjeçari Mandi Begaj u kap gjatë një kontrolli në një lokal në lagjen "Uji i Ftohtë". Në kuadër të planit të masave për goditjen e grupeve kriminale, kapjen e personave në kërkim, apo të atyre që mbajnë e qa-

rkullojnë me armë zjarri pa leje, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë në DVP.Vlorë, kanë ushtruar kontrolle të vazhdueshme në akset rrugore si edhe në ambjente të ndryshme për këtë qëllim. Materialet u referuan në Prokurori ndaj tij për veprën penale "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".



“Ça ke bërë andej nga Kavaja, janë dy makina të zhdukura”

Polici, të kërkuarit: Do takoj “Kapelen”, por s’del në takim, se thotë se i ka mbrapa

që Lila është mundur të arrestohet në datën 25 gusht 2017.

Në bisedat telefonike me nr. 06662XXXX që i përket abonentit Engrid Henaj dhe nr. 06975XXXX nga përgjimet rezultojnë se është përdorur nga i arrestuari Fatjon Lila, rezultojnë se në datën 21 maj 2017, ora 21:51 Engrid Henaj nga numri celular 06662XXXX ka zhvilluar këtë bisedë kundrejt nr. cel. 06975XXXX, i cili thirret nga ana e tij me emrin Fatjon...

Polici: Pse i çon zile e s’merr ai. Dëgjo një çikë për muhabetin tat. Ik kap prokurorin o idiot... Se je akoma në afat... Po ik pra ta mbylli për muhabetin tat o k...

Hajduti: Kush të tha gjë njeri ty...

Polici: Po e di unë... ik te prokurori atje ta mbylli mos të lëshojë urdhër-arresti se ike në kokërr të burgut...

Hajduti: Po ma ç’o e ke emrin e atij atje?

Polici: S’e ka o vëlla, nuk e di kush është aty (ambientale o shoku im e jep se kush prokuror e ka çështjen). S’e jep o vëlla po ik interesohu, fut ndonjërin që të interesohet bo...?...

Polici: Ç’patent o k... për ato makinat b..., ça ke bërë andej nga Kavaja... janë dy makina thotë.

Në fund të bisedës së kësaj date Engridi i thotë Fatjonit se nëse nuk e merr te ky numër ta telefonojë te numri tjetër me 069, dhe ku Fatjoni i thotë se e ka këtë numër dhe më telefono te



Engrid Henaj


efektivi i policisë e njoftojnë të kërkuar Lila se do takojë dhe një person tjetër që ndidej nga policia dhe që mban nofken “Kapelja”, por ky i ka pohuar se mos takoheshin pasi kishte policinë nga mbrapa dhe mund të arrestohej.

Polici SMS: Po unë jam a merr vesht dhe kujdes këto 2 dit, të djellën në darkë takoj unë atë shokun tat nëse shof ke drejtorja a ka filluar naj gjo a jo. Se se s’kam si shof pa vaj.

Polici SMS: Ç’a bone daku? Nesër do shof un ke veni a je në procedim a jo se n’sistem më doli alert (person në kërkim), pasnesër nga darka takoj unë atë shokun tat.

Polici SMS: Do takoj kapelen po m’tha mos takoni se i ka mbrapa kur ta takoj të them ekzakt si është puna.

Nga këqyrja e telefonit rezultojnë se ora dhe data e aparatit celular nuk përkon me kohën reale të kryerjes së bisedave nga këqyrja rezultojnë se këto biseda janë kryer në vitin 2013. Në të vërtetë kjo është një anomali në aparatit celular që mund të jetë dhe me dashjen e personit mbajtës, por nga përgjigjja e kompanive me shkresë e datës 30 gusht 2017, konfirmohet se sms-të e sipërshënuara janë kryer në vitin 2017. Nga veprimet hetimore të deritanishme, si nga studimi i akteve të transkripteve të përgjimeve telefonike dhe procesverbalit i këqyrjes së telefonit datë 24 gusht 2017 rezultojnë se shtetasi Engrid Henaj, punonjëse policie pranë Drejtorisë Vendore Policisë Tiranë, është i implikuar në veprime të kundërligjshme gjatë komunikimit me shtetasin Fatjon Lila, gjatë kohës kur ky i fundit i fshihej ekzekutimit të vendimit penal për masën e sigurimit “arrest në burg”, duke i dhënë informacione rreth çështjes që procedohej nga Prokuroria Kavajë dhe kërkimeve policore që bëheshin ndaj tij. Ky shtetas dyshohet se ka konsumuar veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”.



Faximile nga procesi gjyqësor të mbajtur në Kavajë ndaj Engrid Henaj

← në veprime të kundërligjshme gjatë komunikimit me shtetasin Fatjon Lila, gjatë kohës kur ky i fundit i fshihej ekzekutimit të vendimit penal për masën e sigurimit “arrest në burg”, duke i dhënë informacione rreth çështjes që procedohej nga Prokuroria Kavajë dhe kërkimeve policore që bëheshin ndaj tij. Gjatë dhënies së këtyre informacioneve, shtetasi Fatjon Lila ka qenë në hetim nga Prokuroria Kavajë për veprën penale “vjedhje”. Pas veprimeve hetimore ku u krijua bindja e arsyeshme se shtetasi Fatjon Lila ishte i dyshuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”. Më datën 31 maj 2017 gjykata e Kavajës ka vendosur masën e “arrestit në burg” në mungesë për Lilën. Ndërkohë

Polici Henaj
Nga studimi i akteve të transkripteve të përgjimeve telefonike rezultojnë se shtetasi Engrid Henaj punonjëse policie pranë Drejtorisë Vendore Policisë Tiranë, është i implikuar në veprime të kundërligjshme gjatë komunikimit me shtetasin Fatjon Lila.

SHKURT

PRANGOSET BESMIR SULA

Kërkohej për tentativë vrasje arrestohet i forti i Bulqizës

Policia e Bulqizës ka arrestuar në zonën e Zerkanit, 31-vjeçarin Besmir Sula, i cili fshihej në shtëpinë e gjyshes së tij, pasi kërkohej nga D.V.P. Tiranë për vrasje me paramendim e mbetur në tentativë dhe prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarakë. Gjatë operacionit për kapjen e tij, Sula ka goditur makinën e policisë

duke rrezikuar jetën e punonjëseve të policisë. Besmir Sula, banues në Tiranë, ka ndërruar mbiemrin nga Zeneli në Sula dhe kishte aksione në një firmë për pasurimin e kromit në Ternovë dhe është person me precedent kriminal në fushën e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe krimet ndaj personit.



NGJARJA NË TIRANË

Familja e denoncon për dhunë fizike, pranga 79-vjeçarit

Një 79-vjeçar është arrestuar pas denoncimit nga familja për dhunë fizike, ndërsa gjatë kontrollit i është gjetur edhe një armë zjarri. Sipas policisë, Avdyl Canalia 79 vjeç është denoncuar se ushtronte dhunë fizike dhe psikologjike ndaj anëtarëve të familjes. Pas njoftimit policia mbërritur në banesë, ndërsa gjatë kontrollit

janë gjendur dhe sekuestruar një armë zjarri, 105 fishekë dhe 60 copë kapsolla. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprat penale “Dhunë në familje” dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak”.



Fëmijët u pajtuan në shkollë, prindërit konfliktohen me armë

Gjykata e Tiranë ka mbyllur në qeli Kleant Musabellin. Polici thotë se u vetëmbrojt

ELTON QYNO
TIRANE

TAKIMI PËR SQARIM

Sipas policisë, dy personazhet e këtij krimi janë takuar tek zona e “Pazarit të Ri” rreth orës 21:00 të së hënës, për tu sqaruar pas një sheri që kanë pasur më herët dy fëmijet e tyre.

ARMË SHËRBIMI

Kleant Musabellin, u arrestua pasi me armën e shërbimit ka plagosur në këmbë shtetasin Pëllumb Gjoka. Më pas Polici i burgjeve Kleant Musabello tentoi të largohet, por është vënë në pranga nga Policia e Tiranës.

burg”. Para gjykata ai ka shfaqur pendesë dhe se përdorimin e armës e ka bërë për vetëmbrojtje, por kjo nuk ka mjaftuar për ti zbutur masën e sigurisë, punonjësit të policisë së burgjeve, që me armën e shërbimit qëllon mbi Pëllumb Gjokën.

ZËNKA PËR FËMIJËT QË ÇOI NË PLAGOSJE

Ngjarja ndodhi mbrëmjen e 11 shtatorit në zonën e “Pazarit të Ri”,

në kryeqytet, ku 43-vjeçari Kleant Musabellin, punonjësi i SHKB-së plagosi me pistoletë në pjesën e këmbës biznesmenin, Pëllumb Gjoka, 46 vjeç. Musabellin dhe Gjoka ishin takuar për t’u sqaruar, por në debat e sipër janë konfliktuar dhe për rrjedhojë punonjësi i SHKB e ka qëlluar atë në këmbë. Një zënkë mes fëmijëve, ka shërbyer për plagosjen me armë të shtetasit Pëllumb Gjoka, që njihet si biznesmen. Kleant



Musabellin, ka qëlluar Gjokën disa herë me armë duke e plagosur në këmbë, por pa mundur ti shkaktojë plagë që do ti rrezikonin jetën. Sipas prokurorisë, dy personazhet e këtij krimi janë takuar tek zona e “Pazarit të Ri” rreth orës 21:00 të së hënës, për tu sqaruar pas një sheri që kanë pasur më herët dy fëmijet e tyre. Por në vend që konflikti i nisur nga fëmijët të shuhej nga prindërit e mëdhenj, këta të fundit i kanë hedhur benzinë zjarrit, duke e rënduar më tepër situatën. Fillimisht ata janë zënë me fjalë dhe më pas kanë filluar goditjet me grushta dhe sende të tjera.

ME ARMËN E SHËRBIMIT

Por kjo situatë ka shërbyer për përdorimin e armës së shërbimit nga ana e shtetasit Musabellin, i cili ka qëlluar disa herë shtetasin

Pëllumb Gjoka, duke i shkaktuar këtij të fundit disa plagë në këmbë. Krismat e armës, kanë sjellë panik në zonë ku menjëherë kanë shkuar dhe shërbimet e policisë së kryeqytetit. Biznesmeni Gjoka është dërguar në spital me urgjencë për të marrë ndihmën e nevojshme dhe mësohet se ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë që policia ka arrestuar autorin e plagosjes dhe gjatë marrjes në pyetje ai ka pranuar autorësinë e krimit dhe ka treguar të gjithë dinamiken e ngjarjes, duke pretenduar se ishte vetëmbrojtur. Ndërkohë që blutë kanë sekuestruar celularët e dy personave të përfshirë në konflikt, për të zbardhur më tej nëse Gjoka dhe autori kanë pasur njohje të mëparshme dhe komunikime të vazhdueshme për këtë problem.

KRIMI NË FAMILJE

Shqiptari vret me thikën e kuzhinës ish-gruan e tij rumune

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pasditen e djeshme në krahinën e Aleksandrisë, në Itali. Një shqiptar ka qëlluar për vdekje ish-gruan e tij, shtetasen rumune, Elena Seprodin. Ngjarja ka ndodhur pas një shërri të ashpër mes çiftit, ku ka qenë shqiptari Kujtim Hasanaj, 49 vjeç, që i ka marrë jetën ish-bashkëshortes në shtëpinë e tij në Casale Monferrato. 49-vjeçari është arrestuar dhe është marrë në pyetje nga karabinierët. Mediat italiane raportojnë për një tradhti mes çiftit të ndarë dhe për një çështje parash. Kanë qenë qytetarët, që kanë dëgjuar thirrjet e gruas, teksa po jepte shpirt, që kanë njoftuar menjëherë policinë. Karabinierët kanë mbërritur në vendngjarje, ku kanë gjetur gruan



Në foto: Elena Seprodi rumunia që u vra nga bashkëshorti shqiptar

e vdekur, si dhe autorin e krimit me thikën e kuzhinës në dorë, të cilin e kanë ndaluar.

GRABITJE NË VLORË

Autorët me maska dhe armë vjedhin 2.3 mln lekë

Një grabitje ka ndodhur dje në Vlorë. Gazetari i “Report Tv” raporton se ngjarja është shënuar në fshatin Sevaster të qytetit bregdetar. Mësohet se grabitësit kanë qenë të armatosur dhe me maska. Nga dyshimet e para, bëhet e ditur se

kanë qenë dy persona, të cilët nën kërcënimin e kallashnikovit iu kanë marrë 1 mln lekë të vjetra dhe 1000 euro dy kasapëve nga Berati. Policia vijon hetimet për të zbardhur detajet e ngjarjes, si dhe për të identifikuar dhe kapur autorët.

OPERACIONI

Arrestohet 20-vjeçari i arratisur nga komisarati



20-vjeçari i arratisur 6 ditë më parë nga ambientet e komisaritit të policisë së Pukës, Emirjon Nika, ka rënë në prangat e policisë së ditën e djeshme. Nika fshihej në një banesë në fshatin Karmë të rrethit të Pukës. Ai iu ikur nga duart policëve në momentin kur do transportohej për në paraburgimin e Shkodrës. 20-vjeçari, banues në “Don Bosko”, ishte arrestuar nga policia me akuzën e grabitjes me dhunë, ndërsa gjykata kishte dhënë masën e sigurisë arrest me burg. Për kapjen e tij u angazhuan 6 grupe të FNSH, si dhe forca të shumta nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër. Pas arratisjes së tij nga komisarati i Pukës, u arrestuan dy punonjësit e policisë Dodë Prela, shef i rendit dhe Pajtim Bushi zëvendës i tij, për “Shpërdorim detyrë”.

NGJARJA NË KORÇË

Kapet mashtruesi i dënuar me 8 muaj burg në Vlorë

Plani i Masave i marrë për të kapur personat e shpallur në kërkim nga Policia e Korçës ka vënë në pranga një person të dënuar me 8 muaj burg me veprën penale “Mashtrimi”. Personi i arrestuar është 27-vjeçari Martin Shehu, banues në Berat. Ndalimi i tij

u bë pasi, Gjakata e Apelit Vlorë me datë 3 maj 2016, e ka dënuar Shehun me 8 muaj burg për veprën penale “Mashtrimi”. Në po këtë Plan-Masash është bërë i mundur edhe ndalimi i një personi tjetër të shpallur në kërkim me veprën penale “Dhuna në familje”.

OPERACIONI NË VLORË

Betonierja merr përpara makinën, shpëton shoferi

Një betoniere ka marrë përpara një makinë në një nga rrugët e qytetit bregdetar, por për fat të mirë nuk ka të lënduar. “Report Tv” ka siguruar pamjet nga aksidenti në Vlorë, ku mjeti i tonazhit të

lartë ka ndaluar në kohë. Policia ka mbërritur në vendin e ngjarjes duke nisur hetimet, ndërsa drejtuesi i mjetit tip “Ford” me targa VL 9442 B i ka prerë rrugën betonieres.

OPERACIONI NË ELBASAN

Tentoi t’i vinte eksplozivin pronës arrestohet 38-vjeçari

Policia e Elbasanit ka ndaluar 38-vjeçar, Thanas Thoma, për veprat penale “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe “Shkatërrimi i pronës me eksploziv, mbetur në ten-

tativë”. Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendim penal kishte caktuar masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”, ndërsa Gjykata e Apelit Durrës me vendim penal ka caktuar masën e sigurisë “Arrest me burg”.

DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka bërë publike të gjithë procedurën që ndiqet për të siguruar vet vitet e pensionit, pavarisht se mund të mos keni punë. ISSH sqaron se në këtë skemë përfshihen të gjithë personat kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyruar.

ÇFARË PËRFITOHET NGA SKEMA

Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar përfiton: Pensionit të plotë të pleqërisë. Pensionit të pjesshëm të pleqërisë. Pensionit të reduktuar të pleqërisë. Pensionit të invaliditetit. Pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe ka të njëjtin rregull me kontributin e detyrueshëm.

SA ËSHTË MASA E KONTRIBUTIT

Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurimin vullnetar nga personi i interesuar, është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensione, sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. Kuota mujore e sigurimit vullnetar për vitin 2017 është 5 184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie, aplikohen zbritje në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje:

•6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit Janar);

•3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar);

•1.5% mbi shumën për një pagesë 3 mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar). Por pagesat e vitit korent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 5 184 lekë, deri në kufi të pagës maksimale. Përfitimet nga sigurimi vullnetar për vitin korent:

•Pensione pleqërie, invaliditeti dhe familjar;

•Pensione më të larta se pen-



Si mund t'i siguronit vetë vitet e pensionit

ISSH sqaron procedurën si të paguani kontributet vullnetare. Rastet kur dëshironi të merrni pension të lartë

PËRFITIMET

Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar përfiton: Pensionit të plotë të pleqërisë. Pensionit të pjesshëm të pleqërisë. Pensionit të reduktuar të pleqërisë. Pensionit të invaliditetit. Pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

sioni social, sipas llogaritjeve mbi shumëfishin e pagave të paguara.

SIGURIM VULLNETAR PËR PERIUDHA TË KALUARA.

Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar mund ti paguajnë sigurimet për vitet e kaluara.

Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pas univesitare është me pagesë. Shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar. Personat që kanë lënë shtetësinë shqiptare mund të bëjnë sigurim vullnetar për mbulimin e periudhave të kaluara nga data 01.01.1994, deri në datën që kanë lënë shtetësinë.

MASA E KONTRIBUTIT PËR SIGURIM VULLNETAR

Masa e kontributit që duhet të

paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa (aplikohet masa që është në fuqi në momentin e kryerjes së pagesës, masë e cila miratohet me VKM, për degën e pensione dhe që për llogaritjen e përfitimeve do t'i korrespondojë pagës minimale të vitit që po mbulohet me sigurim vullnetar). Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar. Në këto pagesa nuk aplikohen zbritje.

SHEMBUJT

Një person që është në prag të mbushjes së moshës ose e ka mbushur moshën që të jetë në kushte përfitimi, minimalisht duhet të ketë 15 vjet periudhë kontributive të siguruar. Në rast se personi ka 12 vjet periudhë kontributive, ka të drejtë të plotësojë 15 vitet e nevojshme duke blerë 3 vjet sigurim nëpërmjet skemës vullnetare.

Masa e kontributit që do të paguhet nga shtetasi do të jetë e barabartë me pagesën aktuale mujore për sigurim vullnetar, e cila aplikohet e tillë për gjithë periudhën tre-vjeçare. Masa kontributive që do të derdhë qytetari për këtë periudhë është 5 184 lekë për një muaj.

Në rastin kur qytetari nuk e ka mbushur moshën, ai mund të blejë periudhë kontributive sa të dëshirojë. Në rastet kur blihen periudha të kaluara nuk aplikohet zbritje.

Përfitimet nga sigurimi vullnetar për periudhat e kaluara:

•Vjetërsi pune, e cila influencën në plotësimin e kushteve për të përfituar një pension;

•Pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar.

Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura

Kush mund të paguajë sigurim

SHEMBULLI

Një person që është në prag të mbushjes së moshës minimalisht duhet të ketë 15 vjet periudhë kontributive të siguruar. Në rast se personi ka 12 vjet periudhë kontributive, ka të drejtë të plotësojë 15 vitet e nevojshme duke blerë 3 vjet sigurim

vullnetar për më shumë të ardhura?

1. Të gjithë personat ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar, të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të siguruar si të tillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

2. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korent në kufijtë e pagave minimale dhe maksimale, 24 000 dhe 105 850 lekë (qytetari ka të drejtë të zgjedhë një pagë brenda këtij kufiri).

Sa duhet të paguhet për sigurim vullnetar për më shumë të ardhura?

a) Personat e vetëpunësuar – sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë. Mbi këtë pagë çdo person ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e pagës maksimale 105 850 lekë.

b) Punëmarrësit – që sigurohen në bazë të kontratës të nënshkruar me punëdhënësin, kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht për më shumë të ardhura mbi pagën që ata marrin deri në nivelin e pagës maksimale 105 850 lekë.

c) Çdo punëdhënësi – që sigurohet

nën nivelin e pagës maksimale ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e kësaj page.

d) Çdo kontribues vullnetar për vitin korent ka të drejtë të sigurohet për më shumë të ardhura.

Përfitimet nga sigurimi vullnetar për më shumë të ardhura:

•Pensione më të larta pleqërie, invaliditeti dhe familjar, sipas kontributit të derdhur.

IV. Sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

Sigurim vullnetar për degë të tjera sigurimi, mund të bëjnë të vetëpunësuarit, për degë të tjera që nuk mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm.

Ky sigurim bëhet nga të vetëpunësuarit vetëm për vitin korent.

Përfitimet nga sigurimi vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

•Paaftësi të përkohëshme në punë.

Periudha e përfitimit për paaftësi të përkohëshme në punë fillon në ditën e 15 të raportit mjekësor dhe zgjat jo më shumë se 6 muaj nga data e fillimit të pagesës. Pagesat e kontributeve për këto degë, bëhen sipas afateve të përcaktuara për pagesat e sigurimit të detyrueshëm (çdo tremujor), vetëm për vitin korent.

Si paguhet sigurimi vullnetar:

1. Personi i interesuar, paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore të vendit ku ai banon dhe merr kontakt me inspektorin e sigurimit vullnetar.

2. Personi i interesuar duhet të ketë me vete dokumentat e mëposhtme:

a) Fotokopje të librezës së punës, ku pasqyrohen periudhat e sigurimit;

b) Fotokopje të librezës së kontributeve, në rast se e disponon;

c) Fotokopje të letërnjoftimit elektronik/ kartës së identitetit.

3. Nëse personi i interesuar bie dakort për t'u siguruar vullnetarisht, do të marrë dokumentin tip "Urdhër veprimi", i cili plotësohet nga inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore.

4. Duke disponuar këtë "Urdhër veprim", personi i interesuar paraqitet në bankë për të bërë pagesën. Me kryerjen e pagesës ai pajiset nga banka me "Mandat arkëtimi".

5. Pas marrjes së mandat arkëtimi, personi i interesuar rikthehet tek inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore, me të cilin lidh marrëveshjen e sigurimit vullnetar, që nënshkruhet nga personi i interesuar dhe inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (një kopje e mandatit i dorëzohet inspektorit në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes).

6. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore është i detyruar të bëjë pasqyrimin në librezë të kontributeve të personit të interesuar, ose të hapë librezë kontributësh të re në qoftë se nuk ka.

Sekretet e RENEA, nga armatimi tek stërvitja speciale

“Military zone”, revista online e specializuar për sigurinë zbulon historinë e forcave speciale shqiptare

Departamenti i Neutralizimit të Elementeve të Armatosura. I njohur zakonisht nga akronimi i saj RENEA, është njësia kryesore kundër-terrorizmit Shqiptare dhe reagimi kritik ndaj incidenteve. Forca u krijua në fillim të viteve 1990 në përgjigje të niveleve në rritje të krimit në vend pas rënies së komunizmit. Përgjegjësitë e RENEA janë operacionet e shpëtimit, situatat e pengjeve, kundër-terrorizmi dhe reagimi ndaj formave veçanërisht të dhunshme të krimit. Që nga viti 1991, njësia ka humbur katër burra në veprim dhe më shumë se dyzet të plagosur. Aftësitë e tyre konsiderohen shumë të mira brenda Shqipërisë dhe në Perëndim dhe janë trajnuar nga GSG.

Pas hyrjes së kapitalizmit në Shqipëri pas vitit 1990, duke dashur të eliminonin të gjitha lidhjet me regjimin komunist, shumë hetues, avokatë dhe oficerë policie u shkarkuan nga puna. Kjo situatë konfuze shpejt e lejoi krimin e organizuar dhe individual të lulëzonte deri në atë pikë saqë shpejt u bë normë e jetës së përditshme. Rrëmbimet, zhvatja, krimi i lidhur me drogën, vrasjet dhe trafikimi i qenieve njerëzore po shfaqeshin për një kohë të



gjatë. Demokracia e re shqiptare nuk pati përvojën ligjore, administrative dhe organizative për të luftuar këto probleme, në fakt infrastruktura e saj ishte pothuajse jo eksistent. Gjatë komunizmit, forca e policisë së cilës iu besuan ndërhyrja e shpejtë dhe misionet e tjera të veçanta, ishte Njësia 326, por për shkak të rolit të saj në shtypjen e trazirave publike

gjatë kryengritjes popullore kundër komunizmit, kjo njësi u la pas dore.

Autoritetet e reja të rendit publik e kuptuan nevojën për një forcë të vogël profesionale dhe pas një përzgjedhje dhe trajnimit të specializuar më në fund u krijua një njësi e re speciale që më vonë u njoh si RENEA. Ajo njihej gjithashtu si Njësia 88. Ajo përbëhej nga tetëdhjetë anëtarë,

ose operativë, të cilët u zgjedhën nga përzgjedhja e 600 anëtarëve origjinal të Njesisë 326. Pjesa tjetër e operatorëve u bashkua me grupet e ndërhyrjes speciale të mëvonshme që erdhën në ekzistencë.

PERZGJEDHJA

Procesi i përzgjedhjes mbahet vetëm një herë në vit dhe zgjat dymbëdhjetë javë. Më pas, rekrutët trajnohen për nëntë muaj të tjerë në aftësi të tjera të tilla si gjuhësia, sinjalet, fotografimi dhe bisedimet për lirim të pengjeve. Kandidatët

gjithashtu vazhdojnë t'i nënshtrohen testeve strikte psikologjike dhe fizike. Vetëm pas një periudhe prej tre vjetësh, rekruti mund të bëhet operator RENEA i lejuar të marrë pjesë në operacionet e shpëtimit të pengjeve. Rreth 90 për qind e kandidatëve vijnë nga degët e tjera të policisë dhe Gardës Kombëtare, ndërsa pjesa tjetër janë ushtarakë. Kandidatët ushtarakë që kalojnë përzgjedhjen duhet gjithashtu të përfundojnë një kurs gjashtë mujor mbi jurisprudencën. Moshë maksimale për përzgjedhje është 26 vjet



Misionet e rëndësishme të RENEA-s

Janar 1991: Në trazirat në burgun e sigurisë së lartë në Shënkoll, një i burgosur i armatosur mori disa roje peng. Vëmendja e mediave kombëtare dhe të huaja u tërhoq nga kriza. Qeveria e kohës dërgoi Njësia 326, paraardhësin e RENEA, i cili ndaloi trazirat duke përdorur gaz lotsjellës dhe plumba gome, pa gjakderdhje. Një operativ u plagos lehtë në këtë proces.

Nëntori 1992: Shqipëria u rrënuar nga përmblytjet masive, të cilat përmblytën shumë pjesë të vendit. RENEA shpërndau ushqimin dhe siguroi strehim dhe ndihmë mjekësore shpejtë me anije me motor dhe helikopter. Një operativ (i vrarë në krye të detyrës në gusht të vitit 1993) u zhyt në vetëmohim në ujërat e akullta dhe shpëtoi tre barinj që ishin duke u mbytur.

Prill 1996: Në një takim diplomatik të nivelit të lartë midis presidentit italian Oscar Luigi Scalfaro dhe Sali Berisha në Tiranë, një individ i çmendur i armatosur me një granatë me shiritin e sigurisë të hequr kërkoi t'i afrohej dy presidentëve.

RENEA larguan dy zyrtarët nga vendi i ngjarjes, ndërsa një negociator i RENEA iu afrua autorit të krimit dhe arriti të bënte kontakt me të duke i rrotulluar krahun dhe kështu duke marrë granatën nga dora e tij dhe duke e vendosur spinën e sigurisë në armë sërish.

Janar 1997: Një studente femër në gjendje depresive përshkruante rrugët e Tiranës me një granatë në dorë. Një operator RENEA iu afrua asaj dhe eliminoi situatën pa gjakderdhje.

1997: Gjatë krizës që e hodhi Shqipërinë në një gjendje anarkie si rezultat i rënies së skemave të ndryshme piramidale, ku tre të katërtat e popullsisë humbën kursimet e tyre, RENEA u besua detyrën e ruajtjes së rezervave monetare dhe ari te Banka Kombëtare Shqiptare dhe institucioneve të tjera financiare. RENEA e realizoi këtë detyrë duke hequr të gjitha sendet e vlefshme nga këto vende me anë të disa furgonave IVECO të paarmatosur. Nuk ka humbur as edhe një lekë në këtë proces. Ky operacion, në një kohë kur shumë oficerë të policisë u vranë nga civilë

të zemëruar, mbahet mend nga njësia si Operacioni Kamikaze. Gjatë të njëjtit vit, 90 për qind e të gjitha stacioneve policore u plaçkitën dhe u morën nga individë të armatosur. RENEA rimori zotërimin e këtyre objekteve, thirri të gjithë oficerët në punë, dhe rivendosi sistemet e komunikimit dhe të sigurisë. Në shumë raste, operatorët riparuan vetë pronat e dëmtuara.

1998-1999: Gjatë këtyre viteve, RENEA u angazhua në luftime me banda të shumta anembanë vendit, të cilat, si pasojë e anarkisë së vitit të kaluar, ishin të armatosura me armë që varionin nga pajisjet personale deri te artileria dhe bateritë anti-avionë të grabitura nga depot ushtarake.

Korrik 1998: Njësia kreu një mision CT duke arrestuar pesë terroristë egjiptianë të lidhur me al-Kaidën e Bin Ladenit.

Mars 1999: Tre kriminelë të armatosur vranë tre policë dhe katër civilë. Më pas, ata u barrikuan në një shtëpi, duke marrë peng një çift dhe vajzën e tyre 7 muajsh. Një ekip RENEA shkoi, liroi pengjet dhe



ARMËT DHE PAJISJET

PISTOLETAT

- Glock 34
- Beretta PX4 Storm
- Beretta 92FS

ARMË GJYSEM TË RËNDA

- H&K MP5
- H&K UMP

ARMËT E ASSALTIM

- AKM (Albanian Model 56 SOPMOD)
- Beretta ARX160

SNIPERA

- Sako TRG M10
- Sako TRG-42
- H&K HK417



“Njësia më e mirë kundër terrorizmit në Ballkan, RENE A shqiptare”

Që nga viti 1991, njësia ka humbur katër burra në veprim dhe më shumë se dyzet të plagosur

dhe kandidatët pritet të jenë anëtarë të njësive përkatëse të mëparshme për jo më pak se dy vjet. Dy javët e para bëhet një stërvitje special që quhet “Shkundje”, në të cilën pothuajse të gjithë marrin pjesë. Vetëm negociatorët dhe një pjesë e grupit logjistik (pa përfshirë shoferët) përjashtohen. Kandidatët i nënshtrohen testeve të gjata dhe të komplikuar psikologjike dhe të qëndrueshmërisë të dizenuara për të pastruar aplikuesit më të dobët. “Shkundja” është e ashpër, e përbërë nga marshime të detyrueshme në ve-

shje të plotë luftarake. Për origjinën e tyre SAS, operativët duhet të mbajnë një çantë shpine prej 35 kg, AK-47 me tetë karikatorë të plotë, pistoletat me karikatorë, thika, maskë kundër gaz dhe radio. Rrugët e tyre të stërvitjes ushtrohen në motin më të keq, në disa nga terreneve më të vështira që Shqipëria ka për të ofruar: në verilindje malore (pika më e lartë është Korabi, në 2.751 metra) kënetat e Vlorës, Durrësit dhe të Lezhës. Përafërsisht 75 përqind e kandidatëve dështojnë në këtë fazë fillestare. Dita e fundit është e rezervuar për testet

e infiltrimit.

Kandidatët që kanë përfunduar me sukses fazën e parë, kalojnë më pas një test të fortë. Ata lihen në një pjesë të humbur të Shqipërisë, në një distancë të sigurt nga kryeqyteti, me 200 komando në kërkim të tyre. Secili prej kandidatëve duhet të kthehet në selinë e Tiranës të vendosur më parë. Nëse ata kapen, ata kthehen në shtëpi. Trajnimi, përgatitja dhe testet ndryshojnë sipas dëshirave të instruktorëve, të cilët vetë janë veteranë të njësive. Ata kanë një reputacion për të qenë të patundur dhe

të pamëshirshëm. Sheepee ishte trajner për rreth 20 vjet derisa ata vendosën se taktikat e tij të trajnimit ishin të vështira dhe joefikase. Ferriku është komandanti aktual i njësive.

ROLI I NEGOCIATORËVE

Prej vitit 1991, negociatorët e njësive kanë zgjidhur, pa përdorur dhunën, më shumë se 500 nga 600 rastet që përfshijnë rrëmbyesit dhe aktet e armatosura. Të gjithë negociatorët duhet të kenë shërbyer jo më pak se dhjetë vjet me forcën policore dhe janë persona me temperament

të mirë dhe balancë mendore, me njohuri të të gjitha dialekteve dhe mentaliteteve rajonale. Ata të gjithë kanë një diplomë në ligj ose kanë marrë pjesë në akademinë e policisë. Përveç kësaj, ata përfundojnë kurse trajnimi me FBI në Akademinë Quantico FBI dhe me agjencitë federale të Shteteve të Bashkuara. Negociatorët janë të parët që ndërhyjnë në rastet e një okupimi me ose pa pengje. Askush nuk ndërhyr pa urdhërin e tyre të qartë, përveç rasteve kur pengu ka vdekur.

Përshtatur nga “Military zone”

në proces vrau kriminelët.

Maj 1999: Një emigrant shqiptar në Greqi, i pakënaqur me pagesën nga punëdhënësi i tij, pasi u ankua tek autoritetet greke dhe u shoqërua në kufi ku u dëbua në Shqipëri. Pasi bleu një AK-47 dhe dy granata, ai u kthye në Greqi dhe shkoi në Selanik, ku mori peng një autobus që mbante katërmëdhjetë njerëz. Qeveria greke i dha atij \$ 250,000 që ai e kishte kërkuar dhe e lejoi të hynte sërish në Shqipëri me pengjet e tij. Në afërsi të Tiranës, (në Qafë-Krrabë) negociatorët kërkuar ta bindnin që të lironte pengjet. Ai plagosi një dhe u vra nga RENE A.

1999: Zani Çausi, udhëheqës i një prej bandave më të pamëshirshme shqiptare, u arrestua. I njëjti fat priti shumë drejtues të shumë bandave të tjera.

1999: Një bandë që kishte mbajtur peng dhe më pas lëshoi një zyrtar të lartë të policisë u arrestua.

1999: Duke vepruar sipas kërkesës së qeverisë italiane, u arrestua një individ i dyshuar për vrasjen e tre policëve në Udine. Megjithatë u lirua nga kjo akuzë,

individi mbeti prapa hekurave për shkak të aktiviteteve të tjera kriminale.

2000-2001: Në tre operacione të veçanta, u arrestuan tre individë të kërkuar për atentatin kundër Azem Hajdarit, një deputet shqiptar. Ky mision ishte i rëndësishëm sepse Hajdari ishte një nga udhëheqësit më joortodoksë dhe polemikë të opozitës politike në atë kohë.

Shkurt 2001: Gjatë operacionit “Udhëtimi në Itali”, RENE A fitoi pikë për shkatërrimin e një bande shqiptaro-amerikane, e cila, në partneritet me kartelin e drogës të Medellin dhe mafien italiane dhe shqiptare, po eksploronte mundësinë e kthimit të Shqipërisë në një urë të madh ndërkombëtar të lëshimit për trafikimin e kokainës. RENE A arrestoi të gjithë të dyshuarit, duke përfshirë një ish oficer të lartë të policisë.

Janar 2002: RENE A shkatërroi një bandë të trafikantëve të narkotikëve, e cila trafikonte 100 kg (202.5 lb) heroinë për udhëtim. Më shumë se 1.000 kg (2.205 lb) heroinë të pastër u konfiskua.

Gjatë dekadës së fundit, RENE A ka

siguruar shoqërimin e sigurinë e zyrtarëve të nivelit të lartë si: ish-Sekretarët e Shtetit të Shteteve të Bashkuara James Baker dhe Madeleine Albright, Papa Gjon Pali II, ish kryeministri britanik Toni Bler, Presidenti Italian Oscar Luigi Scalfaro dhe kryeministra të ndryshëm italianë dhe grekë, përveç zyrtarëve shqiptarë dhe zyrtarëve ndërkombëtarë në misionet qeveritare në Shqipëri.

Qershor 2014: RENE A në një operacion të kombinuar me policinë shqiptare e vuri fshatin e Lazaratit në rrethim për disa javë. Rreth 800 oficerë dhe agentë të policisë morën pjesë në operacion. Operatorët e RENE A luftuan kundër trafikantëve të drogës të armatosur me RPGs, AK-47 dhe armë të tjera të lehta. Dhjetëra u arrestuan dhe tonat e marihuanës dhe heroinës u konfiskuan dhe u dogjën. Nuk pati viktima nga të dyja palët.

Qershor 2015: Për të dytin vit radhazi, fshati Lazarat u vu nën rrethim pasi një operator i RENE A u vra dhe dy të tjerë u plagosën. Pas një përpjekjeje intensive, sulmuesit u dorëzuan.



Lista e qytetarëve që kanë gati lejen e legalizimit

Për certifikatën e pronësisë procedura do të ndiqet nga vet ALUIZNI

DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Publikohet lista me 380 personat të cilët kanë gati lejen e legalizimit të banesave të tyre në qytetin e Vlorës. ALUIZNI-t bën me dije se qytetarët duhet të paraqiten pranë zyrave të ALUIZNI-t, Vlorë, për të tërhequr lejen e legalizimit. Ndërkohë që procedurat për marrjen e dokumentit të pronësisë do të ndiqen nga AULIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë. Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë përfutjesit do të njoftohen për tërheqjen e saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopjete lejes

së legalizimit për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. “Në listën e mëposhtme, përfshihen edhe një numër qytetaresh, leja e legalizimit të të cilëve ka

qenë përgatitur prej kohësh, por ata nuk janë paraqitur për t'i tërhequr ato. Duket disi e çuditshme që, nga njëra anë shumë qytetarë kërkojnë përshejtimin e procesit të legalizimit, ndërsa nga ana tjetër ndeshemi me fenomenin e kundërt, me qytetarë që megjithë përfundimin e procesit të

legalizimit, nuk paraqiten për të tërhequr lejen e legalizimit. Drejtoria e ALUIZNI-t Vlorë ndërkaq lajmeron qytetarët e interesuar se gjatë kësaj periudhe puna e saj po përqëndrohet në zonat e brendshme të qytetit dhe veçanërisht në ato përgjatë Pyllit të Sodës. Të gjithë qytetarët e këtyre



zonave, ftohen të plotesojnë dokumentat e kërkuara nga Agjencia dhe të mbështesin

punonjësit gjatë procesit të punës”, - thotë në një njoftim për shtyp Drejtoria e Aluiznit.

LISTA E QYTETARËVE QË KANË GATI LEJEN E LEGALIZIMIT

Nr	Nr Prot	Emer	Atesi	Mbiemer	Date	Njoftime
1	11 03	Abedin	Xhelal	Metaj	..	Nuk Ka Info
2	23/1	Adelina	Tajar	Baka	1.3.2005	Nuk Ka Info
3	1286/5	Agim	Haxhi	Shehu	16.3.2005	Eshte Njoftuar
4	1285/5	Agim	Haxhi	Shehu	16.3.2005	Nuk Ka Info
5	2862/5	Agim	Hajdar	Caka	13.11.2006	Nuk Ka Info
6	91	Agim	Azbi	Arapi	10.2.2005	Nuk Ka Info
7	1226/4	Agron	Ali	Rustemi	3.3.2005	Nuk Ka Info
8	20	Agron, Drita, Myslym	Qemal, Servet, Agron	Dashalla	19/09/2014	Nuk Pergjigjet
9	131	Albert	Rait	Taka	1.11.2006	Nuk Ka Info
10	663	Albert	Hamet	Myrteza	2014	Nuk Ka Info
11	6040	Albert	Paskal	Petraj	28/01/2015	Nuk Ka Info
12	369/5	Albert	Pellumb	Myrtaj	16.3.2005	Nuk Pergjigjet
13	810	Albert	Hydo	Kapllani	2005	Nuk Ka Info
14	801	Aleks, Blerina	Batjar, Mishel	Culanaj	15.07.2013	Nuk Ka Info
15	1013	Aleksander	Bejo	Bushaj	17.07.2013	Nr.i Padis-ponueshëm
16	789/4	Alfred	Veis	Bleta	24.3.2005	Nuk Ka Info
17	95	Alfred	Kadri	Jasini	10.2.2005	Eshte Njoftuar
18	1	Alfred	Pabndeli	Lala	10.2.2005	Nuk Ka Info
19	5001	Alfredi	Toli	Lepuri	23/01/2015	Nuk Ka Info
20	695/1	Aliko	Shaqo	Brahimi	20.3.2005	Nuk Ka Info
21	1550/4	Andon	Muarrem	Alliraj	20.3.2005	Nuk Ka Info
22	33	Andon	Josif	Greku	21.2.2005	Nuk Ka Info
23	275/4	Andrea	Refat	Hyseni	17.3.2005	Nuk Ka Info
24	407/1	Andrea	Shaqo	Brahimaj	25.3.2005	Nuk Ka Info
25	1249/1	Anest	Ferat	Musta	11.9.2006	Nuk Ka Info
26	399	Anesti	Kaco	Prifti	2.8.2006	Nuk Ka Info
27	318/4	Arben	Shaqo	Hasaj	10.2.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
28	1581/1	Arben	Mersin	Osmani	10.11.2006	Nuk Ka Info
29	2423/4	Arben	Ramo	Osmani	28.7.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
30	2215	Arben	Bilbil	Hodaj	10/12/2014	Nuk Ka Info
31	4614	Arben	Gani	Ogici	21/01/2015	Nuk Ka Info
32	18 03	Arben	Dhimiter	Verore	2005	Nuk Ka Info
33	489/1	Ardian	Ylli	Saliaj	15.3.2005	Nuk Ka Info
34	901	Ardjan	Vllasi	Lepuri	2/11/2016	Nuk Ka Info
35	900	Ardjan	Vllasi	Lepuri	2/11/2016	Nuk Ka Info
36	24/1	Arjan	Tajar	Baka	1.3.2005	Nuk Ka Info
37	615/5	Arjan	Xhemal	Rama	23.3.2005	Eshte Njoftuar
38	2033/4	Arjan	Fejzo	Bushi	4.4.2005	Nuk Ka Info
39	146	Artan	Guri	Resulaj	22/09/2014	Nuk Ka Info
40	3951	Artan	Qerem	Shabanaj	2014	Nuk Ka Info
41	1628/4	Asllan	Hysen	Lukaj	15.3.2005	Nuk Ka Info
42	2054/4	Astrit	Ilmi	Bimo	30.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
43	87/1	Astrit	Dalip	Selaj	13.3.2005	Nuk Ka Info
44	774/1	Astrit	Muharrem	Shyti	30.3.2005	Nuk Ka Info
45	559/5	Astrit	Qani	Pengu	25.3.2005	Nuk Ka Info
46	3699/4	Astrit	Mehmet	Dauti	13.11.2006	Nr.i Padis-ponueshëm

Nr	Nr Prot	Emer	Atesi	Mbiemer	Date	Njoftime
47	1757	Astrit	Meçan	Tahiraj	27/11/2014	Nuk Ka Info
48	2938/4	Avdul	Jakup	Sylejmani	5.9.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
49	1270/5	Baki	Tafil	Aliaj	18.3.2005	Nuk Ka Info
50	1562/5	Bardhosh	Kujtim	Caushaj	10.2.2005	Nuk Ka Info
51	2127/4	Bardhyl	Sali	Lukaj	20.3.2005	Nuk Ka Info
52	1177/4	Bashkim	Goli	Bashllari	24.3.2005	Nuk Ka Info
53	166	Bashkim	Taip	Bocaj	22.11.2006	Eshte Njoftuar
54	731	Bejeko	Fuat	Hodaj	1/10/2014	Nuk Ka Info
55	730	Bejeko	Fuat	Hodaj	1/10/2014	Nuk Ka Info
56	1385/1	Beqir	Alit	Kavaja	4.10.2006	Nuk Ka Info
57	1753/4	Besnik	Qendro	Isufaj	29.3.2005	Nuk Ka Info
58	-	Besnik	Rait	Barjamaj	1.8.2006	Nuk Ka Info
59	653	Besnik	Razip	Skenderaj	29/09/2014	Nuk Ka Info
60	1335/1	Bexhet	Shezai	Idrizaj	19.9.2006	Nuk Ka Info
61	529	Bexhet	Alem	Dervishaj	01.07.2013	Nr.i Padis-ponueshëm
62	1202/4	Bitije	Hakuran	Shimi	15.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
63	376/4	Bledar	Caush	Caushaj	18.3.2005	Nuk Ka Info
64	1892/5	Brahim	Hysenj	Kapaj	24.3.2005	Nuk Ka Info
65	1892/5	Brahim	Hysenj	Kapaj	24.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
66	617/4	Bukuri	Tahir	Pashaj	15.3.2005	Nuk Ka Info
67	18 03	Cerciz	Nazmi	Tahiraj	..	Nuk Ka Info
68	1188/1	Dafina	Spiro	Rina	6.9.2006	Nuk Ka Info
69	1448/1	Dashamir	Nexhip	Islamaj	27.10.2006	Nuk Ka Info
70	6135	Dejvi	Dashamir	Hazizaj	28/01/2015	Nuk Ka Info
71	03 03	Delo	Guro	Sinanaj	2005	Nuk Ka Info
72	290/1	Demir	Bektash	Kapllanaj	17.3.2005	Nuk Ka Info
73	510/1	Demirali	Nuri	Malollari	24.3.2005	Nuk Ka Info
74	693/1	Detanije	Zenel	Brahimaj	25.3.2005	Nuk Ka Info
75	2991/5	Dhimiter	Petro	Moni	20.11.2006	Nuk Ka Info
76	1826/5	Dhimiter	Ali	Luzaj	18.3.2005	Nuk Ka Info
77	715	Dhimitraq	Petro	Mocka	22.11.2006	Nuk Ka Info
78	795/4	Dilaver	Xhevit	Hoxhaj	23.3.2005	Nuk Ka Info
79	942/4	Dritan	Bastri	Sinaj	25.3.2005	Nuk Ka Info
80	21 03	Dritan	Hydai	Islami	2005	Nuk Ka Info
81	367	Dritan	Bashkim	Kasaj	20.06.2013	Nuk Ka Info
82	422/1	Dule	Qazim	Aliaj	24.3.2005	Nuk Ka Info
83	1749/4	Durim	Ramis	Musaraj	29.3.2005	Nuk Ka Info
84	316/5	Durre	Haki	Shabani	16.3.2005	Nuk Ka Info
85	2852/4	Dushan	Mezin	Mezinaj	30.8.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
86	1645/1	Dylber	Qazim	Aliaj	15.11.2006	Nuk Pergjigjet
87	3121/4	Edmond	Rrapo	Braho	1.9.2006	Nuk Ka Info
88	2871/5	Eduart	Pellumb	Shalcanji	13.11.2006	Nuk Ka Info
89	6163	Elidon	Rrapo	Tika	28/01/2015	Nuk Ka Info
90	6279	Eliona	Hazbi	Hazizaj	28/01/2015	Nuk Ka Info
91	625/5	Elmaz	Sadik	Mulaj	21.3.2005	Nuk Ka Info
92	683/2	Engjellush	Shaqo	Kacaj	15.3.2005	Nuk Ka Info
93	1562/1	Enver	Nazif	Musta	9.11.2006	Nuk Ka Info

Nr	Nr Prot	Emer	Atesi	Mbiemer	Date	Njoftime
94	1910/5	Enver	Qemal	Sulaj	20.7.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
95	3235/4	Eqerem	Sali	Ymeraj	15.9.2006	Nuk Ka Info
96	1292/1	Ergus	Viktor	Muharremi	13.9.2006	Nuk Pergjigjet
97		Erjon	Tomorr	Sadedinaj		Nuk Ka Info
98	1428	Ermelinda	Mustafa	Memetaj	2017	Nuk Ka Info
99	3795	Ermir	Sotir	Greku	29/12/2014	Nuk Ka Info
100	1257/4	Esat	Xhemal	Nebiu	22.3.2005	Nuk Ka Info
101	6656	Fadil	Rroko	Ahmetaj	30/01/2015	Nuk Ka Info
102		Fadil	Rroko	Ahmetaj	2005	Nuk Ka Info
103	2066/5	Fanol	Arshi	Memaj	16.8.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
104	1420/4	Faslli	Mersin	Dushku	30.3.2005	Nuk Ka Info
105	781/4	Fatime	Kajmak	Potka	24.3.2005	Nuk Ka Info
106	1234/5	Fatime	Xhemal	Halili	28.3.2005	Nuk Ka Info
107	2795/4	Fatime	Jemin	Sulejmani	28.8.2006	Nuk Ka Info
108	2560/5	Fatime	Bejkush	Shametaj	22.9.2006	Nuk Ka Info
109	902/1	Fatmir	Vero	Beshaj	2.8.2006	Nuk Ka Info
110	3106/4	Fatos	Bexhet	Jonuzaj	8.9.2006	Nuk Ka Info
111	3818/4	Fatos	Jashar	Dulaj	10.11.2006	Nuk Ka Info
112	465/3	Fejzi	Ceno	Memaj	5.9.2006	Nuk Ka Info
113	4277	Fejzi	Nimet	Shametaj	14/01/2015	Nuk Ka Info
114	2233/5	Fejzo	Jemin	Metlli	29.8.2006	Eshte Njoftuar
115	84/4	Ferdinand	Arif	Bashllari	10.3.2005	Nuk Ka Info
116	1801/4	Ferdinand	Qazim	Nasufi	20.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
117	866/4	Ferjat	Kajo	Stora	24.3.2005	Nuk Ka Info
118	67	Feruze	Ali	Roshi	6.9.2006	Nuk Ka Info
119	1498/1	Festim	Kamber	Musta	6.11.2006	Nuk Ka Info
120	4138	Festim	Dino	Alushaj	12/1/2015	Nuk Ka Info
121	512	Fiorentina	Bashkim	Kasaj	01.07.2013	Nuk Ka Info
122	385/4	Flamur	Hair	Maska	18.3.2005	Nuk Ka Info
123	1244/5	Flamur	Mystehak	Rama	28.3.2005	Nuk Ka Info
124	705/1	Frederik	Agush	Musai	18.3.2005	Nuk Ka Info
125	3309/4	Fredi	Daut	Lelaj	29.9.2006	Nuk Ka Info
126	1097/1	Fuat	Iliaz	Sulejmani	30.8.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
127	23 03	Gaqo	Isuf	Mataj	2005	Nuk Ka Info
128	3177/4	Gazmir	Skendo	Demo	12.9.2006	Nuk Ka Info
129	1864	Genci	Vero	Seferaj	2/12/2014	Nr.i Padis-ponueshëm
130	2524	Gentjan	Nikollaq	Doko	15/12/2014	Nuk Ka Info
131	879/1	Gezim	Skender	Mihaj	17.3.2005	Nuk Ka Info
132	1675/1	Gezim	Banush	Rakipaj	15.11.2006	Nuk Ka Info
133	2877/5	Gezim	Sejko	Sejko	13.11.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
134	432	Gezim	Halil	Jupe	10.8.2006	Nuk Ka Info
135	127	Gezim	Rushan	Memushi	27.10.2006	Nuk Ka Info
136	39/1	Gjergji	Arshi	Golemaj	11.3.2005	Nuk Ka Info
137	2279/4	Gjysh	Halim	Nushaj	18.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
138	4586	Granit	Vangjel	Greku	21/01/2015	Nuk Ka Info
139	1134/5	Guri	Qerim	Bregu	27.3.2005	Nuk Ka Info
140	40	Habil	Maze	Golaj	2005	Nuk Ka Info
141	1928/5	Hajdar	Xhemal	Hysenaj	31.7.2006	Nuk Ka Info
142	620/5	Hajredin	Xhezair	Qejvanaj	22.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
143	848/4	Halim	Faslli0	Hoxhaj	22.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
144	1503/4	Hamza	Mehmet	Xhaferri	27.3.2005	Nuk Ka Info
145	2073/5	Hasan	Mehmet	Canaj	18.8.2006	Eshte Njoftuar
146	4958	Hasan	Xhafer	Dishani	23/01/2015	Nuk Ka Info
147	1980/4	Hateme	Sadik	Isufi	30.3.2005	Nuk Ka Info
148	1371/5	Hekuran	Hysen	Cipi	20.3.2005	Nuk Ka Info
149	-	Hydo	Zenel	Kapllani	2005	Nuk Ka Info
150	2897/5	Hyrie	Muco	Gorica	14.11.2006	Nuk Ka Info
151	1365/1	Hysen	Niazi	Kapllani	10.10.2006	Nuk Ka Info
152	1254/5	Idajet	Xhevit	Shehaj	20.3.2005	Nuk Ka Info
153	826	Ilir	Pellump	Caushllari	1/1 0/2014	Nuk Ka Info
154	696/1	Ilir	Maksut	Sulaj	20.3.2005	Nuk Ka Info
155	2479/5	Ilir	Kujtim	Kurani	13.9.2006	Nuk Ka Info
156	1267/5	Ilir	Qani	Calaj	18.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
157	1482/4	Ilirjan	Ilmi	Caushi	19.3.2005	Nuk Ka Info
158	529	Ilirjan	Hasan	Basho	6/27/1905	Nuk Ka Info
159	1145/4	Ilmi	Riustem	Halilaj	20.3.2005	Eshte Njoftuar
160	5333	Ilmi	Faik	Kasaj	26/01/2015	Nuk Ka Info
161	3632	Irakli	Josif	Greku	26/12/2014	Nuk Ka Info
162	45/1	Islam	Alim	Boraj	21.2.2005	Nuk Ka Info
163	3810/4	Isuf	Shaban	Ahmeti	20.11.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
164	3450	Izmir	Agron	Skenderaj	24/12/2014	Nuk Ka Info
165	2947/4	Jakup	Sylejman	Sulejmani	4.9.2006	Nuk Ka Info
166	1113/1	Jakup	Taip	Brahimi	31.8.2006	Nuk Ka Info

Nr	Nr Prot	Emer	Atesi	Mbiemer	Date	Njoftime
167	1934/4	Jetnor	Veiz	Muçodemi	20.3.2005	Nuk Ka Info
168	3643/4	Josif	Sadik	Piro	9.11.2006	Nuk Ka Info
169	23-03	Kanan	Selim	Kanani	2005	Nuk Ka Info
170	487/5	Kanan	Faslli	Nazaj	20.2.2005	Eshte Njoftuar
171	3712	Karrilla	Pali	Qarri	26/12/2014	Eshte Njoftuar
172	3736/4	Kasem	Memet	Memeti	14.11.2006	Nuk Ka Info
173	573	Kastriot	Kozma	Qarri	13.9.2006	Nuk Ka Info
174	852	Kastriot	Mevlan	Mucaj	15.07.2013	Nr.i Padis-ponueshëm
175	1	Kate	Shemo	Caushaj	31.8.2006	Nuk Ka Info
176	5757	Krenar	Razip	Skenderaj	28/01/2015	Nuk Ka Info
177	936	Krenar	Habip	Kaso	3/10/2014	Nr.i Padis-ponueshëm
178	1643/4	Kristaq	Nuri	Petanaj	20.3.2005	Eshte Njoftuar
179	1497/1	Kudret	Ismet	Besimaj	6.11.2006	Nuk Ka Info
180	19/4	Kujtim	Sabri	Zotaj	10.3.2005	Nuk Ka Info
181	330/4	Kujtim	Qemal	Aliaj	23.2.2005	Nuk Ka Info
182	2224/4	Kujtim	Sinan	Saliasi	24.3.2005	Nuk Ka Info
183	477/1	Lasko	Tahir	Binozi	15.3.2005	Nuk Ka Info
184	790	Lato	Maze	Golaj	2005	Nuk Ka Info
185	1079/4	Leter	Jazo	Hysaj	17.3.2005	Nuk Ka Info
186	3531	Leter	Muharrem	Berdo	24/12/2014	Nuk Ka Info
187	56	Leter	Gegaj	16.6.2006	21.2.2005	Nuk Ka Info
188	1734/4	Leonardo	Durmish	Ballëshaj	31.3.2005	Nuk Ka Info
189	3009/4	Ligor	Todi	Papaj	6.9.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
190	768/4	Lipi	Josif	Naka	22.3.2005	Nuk Ka Info
191	234	Llazar	Kozma	Seferaj	13.9.2006	Nuk Ka Info
192	690/1	Luan	Zequir	Haxhiaj	14.3.2005	Nuk Ka Info
193	1919/5	Luan	Qerem	Velaj	24.7.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
194	393/5	Luan	Guro	Gockaj	15.3.2005	Nuk Pergjigjet
195	677/5	Lulzim	Jashar	Dauilla	15.3.2005	Eshte Njoftuar
196	2993/4	Lutfi	Jakup	Sulejmani	5.9.2006	Nuk Ka Info
197	161/5	Lutfi	Rait	Merkaj	3.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
198	544/1	Luto	Sali	Derraj	15.3.2005	Nuk Ka Info
199	1649/4	Maksim	Reshat	Dida	18.3.2005	Nuk Ka Info
200	276	Maksim	Selim	Danaj	22/09/2014	Nuk Ka Info
201	4831	Malko	Sadik	Durmishi	22/01/2015	Nuk Ka Info
202	3481/4	Mamo	Nuri	Abazi	31.10.2006	Nuk Ka Info
203	894/5	Mane	Veip	Mema	15.3.2005	Eshte Njoftuar
204		Mariglen	Rait	Takaj	2005	Nuk Ka Info
205	6745	Mariglen	Murat	Brahimaj	30/01/2015	Nuk Ka Info
206	283	Matjan	Islam	Arap	23.3.2005	Nuk Ka Info
207	2084/5	Maze	Rakip	Bleta	17.8.2006	Nuk Ka Info
208	803/1	Medin	Nuhu	Lamaj	12.2.2005	Nuk Ka Info
209	6139	Mehmet	Xhemil	Hazizaj	28/01/2015	Nuk Ka Info
210	799/1	Meleq	Neki	Gjikaj	17.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
211	23 03	Mihal	Feta	Murati		Nuk Ka Info
212	2399/5	Mihal	Imer	Metaj	8.9.2006	Nuk Ka Info
213	197	Mihal	Dhori	Mone	9.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
214	5613	Minella	Ristan	Greku	27/01/2015	Nuk Ka Info
215	6257	Minella	Kozma	Ngjelo	28/01/2015	Nuk Ka Info
216	3495	Miranda	Sali	Mitro	24/12/2014	Nuk Ka Info
217	1543/5	Mirjan	Gjolek	Sula	30.3.2005	Eshte Njoftuar
218	2/1	Mjaftim	Koci	Jonuzaj	9.3.2005	Nuk Ka Info
219	346/1	Muco	Hate	Mucaj	20.3.2005	Nuk Ka Info
220	2501/4	Muharrem	Osmen	Manaj	9.8.2006	Nuk Ka Info
221	1619/5	Murat	Myftar	Mema	25.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
222	3356/4	Murat	Myrteza	Sula	10.10.2006	Nuk Ka Info
223	52/2/98	Musa	Mezan	Nuredini	24.8.2006	Eshte Njoftuar
224	2615/5	Myslyme	Cuman	Lulaj	9.10.2006	Nuk Ka Info
225	2176/4	Naife	Sulo	Lara	20.2.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
226	352/2	Naim	Zequir	Zeaj	18.3.2005	Nuk Ka Info
227	1459/5	Namik	Razip	Merkaj	27.3.2005	Nuk Ka Info
228	1269/1	Nasip	Jaup	Ceka	18.8.2006	Nuk Ka Info
229	1332/4	Nazmi	Jakup	Aliu	17.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
230	1450/2	Neshat	Xhevdet	Nguci	.3.2005	Nuk Ka Info
231	680/1	Nexhip	Tofik	Llanaj	30.3.2005	Nuk Ka Info
232	1995	Nikollaq, Arjanthi	Vangjel, Llazi	Llambi	4/12/2014	Nuk Ka Info
233	859/1	Njazi	Barjam	Banushaj	30.3.2005	Nuk Ka Info
234	2031/5	Novrus	Barjam	Hamata	14.8.2006	Nuk Ka Info
235	1616/5	Nuri	Azbi	Metaj	31.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
236	1688/4	Nuri	Rrapo	Halilaj	15.3.2005	Nuk Ka Info
237	814/1	Nurke	Hasan	Alikaj	25.4.2005	Nuk Ka Info
238	5968	Ollga	Jorgji	Petraj	28/01/2015	Nuk Ka Info

Nr	Nr Prot	Emer	Atesi	Mbiemer	Date	Njoftime
239	1582/4	Pajtim	Ramiz	Lushjaku	31.3.2005	Nuk Ka Info
240	2868/4	Panajot	Hamza	Nebiu	31.8.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
241	569	Panajot	Spiro	Kola	02.07.2013	Nuk Ka Info
242	9	Pazait	Guri	Hodaj	21.2.2005	Nuk Ka Info
243	121/4	Pelivan	Hasan	Hasanaj	11.2.2005	Nuk Ka Info
244	564/4	Pelivan	Refat	Rrapaj	30.3.2005	Nuk Ka Info
245	849/5	Pellumb	Selim	Shahaj	24.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
246	1149/4	Perikli	Jani	Papaj	26.3.2005	Nuk Ka Info
247	118	Perparim	Haki	Lamaj	3.10.2006	Nuk Ka Info
248	1548/5	Petraq	Jorgo	Petraj	20.3.2005	Eshte Njoftuar
249	6023	Petraq	Kozma	Mojallia	28/01/2015	Nuk Ka Info
250	1098/1	Petrit	Fuat	Sulejmani	30.8.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
251	1415/4	Petro	Riza	Papa	21.3.2005	Nuk Ka Info
252	41	Petro	Milo	Thanasi	19/09/2014	Nuk Ka Info
253	2067/5	Piro	Fanol	Memaj	16.8.2006	Nuk Ka Info
254		Piro	Namik	Çepaj	24.8.2005	Nuk Ka Info
255	89/3 A1	Polizoi	Jorgji	Xhaxho	2005	Nuk Ka Info
256	18 03	Pushime	Baxhul	Lelaj	2005	Nuk Ka Info
257	1472/5	Qamile	Bilbil	Haxhij	31.3.2005	Eshte Njoftuar
258	534/1	Qani	Nuh	Dule	15.3.2005	Nuk Ka Info
259	798	Qani	Hatem	Celaj	2005	Nuk Ka Info
260	1802/4	Qazim	Rexhep	Nasufi	20.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
261	16 02	Qemal	Nuredin	Gjonaj	2005	Nuk Ka Info
262	2610/4	Qenan	Ismet	Cane	17.8.2006	Nuk Ka Info
263	727/4	Rahman	Ali	Ajasllari	23.3.2005	Nuk Ka Info
264	3464/4	Rako	Miter	Prifti	30.10.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
265	1470/4	Ramadan	Selim	Bogdani	28.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
266	2245/5	Ramis	Abip	Zhupaj	30.8.2006	Nuk Ka Info
267	684/1	Ramiz	Tofik	Muharremaj	30.3.2005	Eshte Njoftuar
268	862/1	Rasim	Isuf	Veipi	30.3.2005	Nuk Ka Info
269	1768/4	Razip	Hariz	Aliaj	24.2.2005	Nuk Ka Info
270	53/5	Refit	Shaban	Piro	10.3.2005	Nuk Ka Info
271	3939	Reis	Sami	Haxhiraj	6/1/2015	Nuk Ka Info
272	10 03	Remzi	Ymer	Caushi	2005	Nuk Ka Info
273	353/1	Reshat	Dano	Demiri	16.3.2005	Nuk Ka Info
274	230/4	Resul	Xhezair	Qejvani	16.3.2005	Nuk Ka Info
275	728/4	Reuf	Nesim	Kryemadhi	23.3.2005	Nuk Ka Info
276	6351	Reuf	Sani	Haxhiraj	28/01/2015	Nuk Ka Info
277	2966/5	Rexhep	Gazali	Zeneli	15.11.2006	Nuk Ka Info
278		Ridvan	Hair	Selimaj		Nuk Ka Info
279	3383	Riza	Kujtim	Kafaraj	23/12/2014	Nuk Ka Info
280	6211	Robert	Hiqmet	Hitaj	28/01/2015	Nuk Ka Info
281	15 03	Roland	Ymer	Caushi	2005	Nuk Ka Info
282	5540	Rrahim, Uranie	Belul, Tefi	Feneraj	27/01/2015	Nuk Ka Info
283	1706/1	Salibe	Dule	Lilaj	21.11.2006	Eshte Njoftuar
284	787/4	Sami	Hajro	Demollari	19.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
285	780/5	Samit	Axhem	Goxha	18.3.2005	Eshte Njoftuar
286	327/4	Sazan	Hetem	Kaloci	17.3.2005	Nuk Ka Info
287	813/4	Sefiste	Hekuran	Matraku	24.3.2005	Nuk Ka Info
288	484/1	Seit	Shefit	Rikaj	16.3.2005	Nuk Ka Info
289	497/5	Selam	Mustafa	Arapaj	21.3.2005	Nuk Ka Info
290	2387/5	Selami	Perllat	Runa	7.9.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
291	5	Selman	Hysen	Bodo	9.2.2005	Nuk Ka Info
292	1707/1	Sezai	Nuredin	Januzaj	7.11.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
293	6346	Shefit	Gjolek	Xhelaj	28/01/2015	Eshte Njoftuar
294	2193/4	Shefqet	Hasan	Hasanaj	8.4.2005	Eshte Njoftuar
295	252/1	Shefqet	Shahin	Kocij	18.3.2005	Nuk Ka Info
296	222/1/82	Sheref	Namik	Lamaj	13.9.2006	Nuk Ka Info
297	2511/4	Shkelqim	Qamil	Çela	10.8.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
298	23 02	Shkelqim	Fahri	Qemali	..	Nuk Ka Info
299	2646/5	Shkelqim	Skender	Zaimi	17.10.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
300	2932	Shkelqim	Kadri	Binozi	19/12/2014	Nuk Ka Info
301	2525	Shkelqim	Nuri	Musaraj	15/12/2014	Nuk Ka Info
302	3165	Shpetim	Eqerem	Nazeraj	22/12/2014	Nuk Ka Info
303	2647/5	Shqiponja	Muhamet	Tozaj	17.10.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
304	-	Skender	Mehemet	Katiaj	11.10.2006	Nuk Ka Info
305	4049	Skender	Selim	Danaj	8/1/2015	Nuk Ka Info
306	771	Sofa	Jaup	Demaj	Objekt Pa Leje	Nuk Ka Info

Nr	Nr Prot	Emer	Atesi	Mbiemer	Date	Njoftime
307	1658/5	Sokol	Reis	Likaj	20.4.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
308	30 03	Sokrat	Selam	Idrizi	2005	Nuk Ka Info
309	1816/5	Sokrat	Veis	Billa	5.4.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
310	760/4	Spiro	Dino	Kacorri	15.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
311	2528/4	Spiro	Dino	Kaçorri	11.8.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
312	3902	Spiro	Adem	Fegaj	5/1/2015	Nuk Ka Info
313	3017/4	Sulejman	Rakip	Zeneli	5.9.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
314	1602/1	Syrja	Dervish	Zotaj	13.11.2006	Nuk Ka Info
315	640/4	Tahir	Avdulla	Rustemi	14.3.2005	Eshte Njoftuar
316	1445/5	Tajar	Jaup	Jaupaj	23.3.2005	Eshte Njoftuar
317	1882/4	Tana	Bilbil	Rrapaj	24.3.2005	Nuk Ka Info
318	2407	Tatjana	Lefter	Shkurti	12/12/2014	Nuk Ka Info
319	6034	Teferi	Halil	Halla	28/01/2015	Nr.i Padis-ponueshëm
320	4757	Tokli	Niko	Dila	22/01/2015	Nuk Ka Info
321	796/5	Tomor	Kujtim	Demiraj	21.3.2005	Nuk Pergjigjet
322	2088	Tomor	Nimet	Kolaj	5/12/2014	Nuk Ka Info
323	23-02	Tomorr	Elham	Satedini	2005	Nuk Ka Info
324	2339/5	Toni	Halim	Veizaj	5.9.2006	Nuk Ka Info
325	23-02	Trim	Rako	Shametaj	2005	Nuk Ka Info
326	1800/4	Valter	Qazim	Nasufi	20.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
327	1717/1	Valter	Mystehak	Xheka	23.11.2006	Nuk Ka Info
328	3070	Vangjel	Istref	Begaj	22/12/2014	Nuk Ka Info
329	1606/5	Vangjel	Koli	Mino	15.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
330	4083	Vangjel	Thanas	Baka	9/1/2015	Nr.i Padis-ponueshëm
331	187	Vangjel	Kozma	Hajdini	16.3.2005	Nuk Ka Info
332	387/4	Vasil	Mevlud	Pasho	18.3.2005	Nuk Ka Info
333	1200	Vasillaq	Petro	Andreas	13/10/2014	Nuk Ka Info
334	2497	Vasillaq	Kozma	Janku	15/12/2014	Nuk Ka Info
335	1192/5	Veli	Pasho	Resulaj	24.3.2005	Nuk Ka Info
336	1183/4	Velide	Luman	Kapllanaj	24.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
337	581/4	Vesel	Tare	Malushi	27.3.2005	Nuk Ka Info
338	1276/4	Vezir	Pelivan	Veshaj	.3.2005	Eshte Njoftuar
339	2674	Viktor	Thanas	Gjonca	17/12/2014	Nuk Ka Info
340	854/1	Vilson	Feti	Kapllanaj	27.3.2005	Nuk Ka Info
341	1718/1	Violeta	Myzafer	Myftiu	23.11.2006	Nuk Ka Info
342	3152	Viron	Dervish	Hyskaj	22/12/2014	Nuk Ka Info
343	2259/4	Vizhdan	Laze	Kapaj	10.3.2005	Nuk Ka Info
344	1675/4	Vjo0llca	Besim	Hykollari	25.3.2005	Nuk Ka Info
345	551/5	Vjollca	Ali	Aliaj	22.3.2005	Nuk Ka Info
346	5364	Vjollca	Janaq	Papa	26/01/2015	Nuk Ka Info
347	2904/4	Vladimir	Qamil	Mecani	30.9.2006	Nuk Ka Info
348	257	Vladimir	Kozma	Prifti	23.3.2005	Nuk Ka Info
349	3352/4	Vllasi	Vangjel	Qarri	10.10.2006	Nuk Ka Info
350	2930/4	Xhafo	Tetem	Lika	1.9.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
351	1455/5	Xhebro	Hasan	Rrapaj	23.3.2005	Nuk Ka Info
352	3307/4	Xhelo	Daut	Lelaj	29.9.2006	Nuk Ka Info
353	3775/4	Xhemal	Rushan	Musto	15.11.2006	Nuk Ka Info
354	07 03	Xhemal	Sadik	Bejtaj	2005	Nuk Ka Info
355	393/4	Xhemil	Avdul	Verca	2.3.2005	Nuk Ka Info
356	377/4	Xhevair	Jace	Sadikllari	1.3.2005	Nr.i Padis-ponueshëm
357	2547/4	Xhezmi	Çomo	Kerri	14.8.2006	Nuk Ka Info
358	3887	Xhezmi	Hekuran	Hoxha	31/12/2014	Nuk Ka Info
359	25/1	Xhezmi	Hekuran	Hoxhaj	9.3.2005	Nuk Ka Info
360	165/1	Xhuljeta	Selam	Xhaferi	14.3.2005	Nuk Ka Info
361	1320/4	Ylli	Nuri	Breshanaj	15.2.2005	Eshte Njoftuar
362	1278/1	Ylli	Sotiraq	Culanaj	12.9.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
363	978/1	Ylli	Faik	Demiraj	16.8.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
364	1471/5	Ylli	Beqir	Bari	15.3.2005	Nuk Pergjigjet
365	1032/4	Ymerli	Zyfer	Ballabani	10.3.2005	Nuk Ka Info
366	1748	Zaim	Hamit	Kocij	21.11.2006	Nuk Ka Info
367	3199/4	Zambak	Nevruz	Hoxhallari	13.9.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
368	1069/1	Zamir	Çako	Jaupaj	28.8.2006	Nuk Ka Info
369	907/1	Zenel	Myrtezan	Dajka	3.8.2006	Nuk Ka Info
370	2940/5	Zenel	Skender	Skendaj	15.11.2006	Nr.i Padis-ponueshëm
371	1789	Zeqir	Sinan	Fallanaj	1/12/2014	Nuk Ka Info
372	29 00	Zija	Hysepi	Avdulaj	2005	Nuk Ka Info
373	464	Zini	Murat	Murataj	27.06.2013	Nuk Ka Info

Alarmohet Japonia, Koreja e Veriut godet sërish me raketë

Raketa ka fluturuar mbi Japoninë e ra në det. Reagon NATO: Duhet përgjigje globale

Koreja e Veriut nuk heq dorë nga provokimet. Vendi komunist lëshoi një tjetër raketë balistike mbi Japoni, e dyta brenda disa javësh, duke krijuar tensione të reja në rajon. Raketa arriti një lartësi prej rreth 770 km duke fluturuar në një distancë prej 3.700 km përpara se të binte në oqean, rreth 2 mijë kilometra në lindje Hokkaidos. Menjëherë ka reaguar edhe pallati presidencial

i Koresë së Jugut, duke thirrur një takim urgjent të Këshillit Kombëtar të Sigurimit. Ashtu si me provën e fundit të 29 gusht-it, raketa fluturoi mbi ishullin verior të Hokkaido-s të Japonisë, përpara se të binte në Oqeanin Paqësor. Nuk pati njoftime për dëmtim të avionëve apo anijeve, ndërsa u dërguan alarme në të gjithë Japoninë, duke paralajmëruar njerëzit që të mbroheshin në vendstrehime të sigurta. Lëshimi i raketës ndodhi

një ditë pasi Koreja e Veriut kërcënoi të fundosë Japoninë dhe se do t'i bëjë "hi" Shtetet e Bashkuara për shkak të mbështetjes së rezolutës së Këshillit të Sigurimit për të vendosur sanksione të reja ndaj saj për shkak të provës bërthamore të 3 shtatorit.


REAGON NATO

NATO ka reaguar pas hedhjes së raketës së dytë balistike nga Koreja e Veriut. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e cilë-



soi verpimin e Koresë së Veriut si "shkelje e pamatur e rezolutave të OKB-së", ndërsa kërkoi edhe një përgjigje globale. "Lëshimi i një rakete nga Koreja e Veriut është një shkelje tjetër e rrezikshme e rezolu-

tave të OKB-së që ndalon për Pheni-anin çdo zhvillim të armëve balistike dhe bërthamore. Ky kërcënim i madh kundër paqes dhe sigurisë ndërkombëtare kërkon një përgjigje botërore", shkruan Stoltenberg në Twitter.



SHPËRTHIMI NË METRO

Terrorizmi godet sërish Londrën, 22 të plagosur në metro

Një shpërthim ka ndodhur dje në metronë e Londrës, në Britaninë e Madhe. Sipas autoriteteve britanike ka pasur 22 të lënduar, disa prej të cilëve me plagë e djegie në fytyrë, nga shpërthimi i një bombe të improvizuar në stacionin e metrosë "Parsons Green" në

jugperëndim të Londrës. Autoritetet britanike e klasifikuan episodin si "akt terrorist". Dëshmitarët në vendngjarje flasin për një lëmsh flakësh dhe vrapimin e rrëmujshëm të njerëzve të tmerruar. "Njerëzit filluan të shtyheshin e të rrëzoheshin në tokë. Kishte fëmijë të vegjël që shkonin

për në shkollë. Njerëzit ishin në panik të plotë", thotë një dëshmitar. Policia gjeti një kovë të mbushur me lëndë plasëse në vagonin e njërit prej trenave në stacionin "Parsons Green", ku shërbimet u pezulluan për kohësisht. Ekspertët thonë se bëhej fjalë për një bombë artizanale, aspak të

sofistikuar. "Mendimet tona janë me të plagosurit, ndërsa ekipet e ndërhyrjes së shpejtë po i përgjigjen trimërisht këtij incidenti terrorist", shkroi në "Twitter" kryeministria Theresa May, e cila thirri me urgjencë mbledhjen e Komitetit qeveritar të Emergjencave, "Cobra".

ARMËT NGA RUSIA

SHBA, senatori Cardin: Mund të ketë sanksione ndaj Turqisë

Senatori demokrat, Ben Cardin, thotë se Turqia mund të ballafaqohet me sanksione automatike amerikane, për shkak të blerjes aktuale të sistemeve rakitore kundërajrore nga Rusia, pasi kjo mund të paraqes shkelje të legjislacionit të Shteteve të Bashkuara. Cardin, anëtar i Komitetit për raporte të jashtme të Senatit të Shteteve të Bashkuara, këtë vërejtje e ka bërë në letërën e djeshme dërguar administratës së presidentit,

Donald Trump. Në letër theksohet se blerja e raketave ruse të tipit S-400 nga ana e Ankarasë, që ishte finalizuar para disa ditësh, paraqet shkelje të sanksioneve të Shteteve të Bashkuara kundër Rusisë, që ishin shndërruar në ligj në muajin gusht. Cardin ka theksuar se ky legjislacion kërkon sanksione për "çdo person që ndërmerr transaksione të rëndësishme" me mbrojtjen e Rusisë ose me sektorët e inteligjencës.



Ben Cardin

"Zapad 2017" Rusia i nxjerr "dhëmbët" NATO-s, stërvitje ushtarake

Rusia dhe Bjellorusia po zhvillojnë stërvitjen ushtarake "Zapad 2017" me 13 mijë ushtarë në terren, demonstrimi më i madh ushtarak ky ndër vite. Në këtë stërvitje, 7 200 ushtarë janë nga Bjellorusia dhe 5 500 të tjerë janë nga Rusia. Rreth 70 avionë, 10 anije dhe 680 automjete tokësore, duke përfshirë 250 tanke, po marrin pjesë gjithashtu në manovra. Gjatë stërvitjeve, personeli do të ushtrojë misione anti-terroriste. Stërvitja ushtarake "Zapad 2017" është ndjekur edhe nga presidenti rus, Vladimir Putin. Ky demonstrim ushtarak i Rusisë ka shkaktuar pakënaqësi në selinë e NATO-s të cilët e shohin si kërcënim për paqen dhe sigurinë në botë.



Vladimir Putin



Paul McClean

Paul McClean
Markets Reporter, Financial Times

SRI LANKA

Gazetari humb jetën nga sulmi i krokodilëve

Një gazetar britanik ka humbur jetën në Sri Lanka, teksa po lante duart buzë një lumi në momentin kur u sulmua nga krokodilët. Paul McClean, 24 vjeç, nga Thames Ditton në Surrey, u tërhoq në një lumë pranë Arugam Bay nga krokodilët, thanë dësh-

mitarët. Policia lokale raportoi se trupi i McClean u gjet në një lagunë nga një ekip kërkimi i Marinës së Sri Lankës. Redaktori i Financial Times (FT) Lionel Barber, shkroi në Twitter: Paul McClean ishte një gazetar i shkëlqyer i ri dhe me një të ardhme të madhe në FT.

Kasimati, Diploma e 1940-s, e mbrojtur ne Universitetit e Torinos

Tezën e diplomës “Fauna iktike e ujërave të ëmbla të Shqipërisë” Kasimati e mbrojti deri në fund të jetës së saj

FERDINANT BEGO*
TIRANE

R egjimi komunist jo vetëm i mori jetën para kohe padrejtësisht, por dhe u përpoq që ta fshijë nga kujtesa e kombit veprën dhe kontributin shkencor të studiueses së nderuar Sabiha Kasimati. Ajo që sot ka mbërritur duke i mbijetuar kohërave të vështira të së kaluarës komuniste mund të konsiderohet si maja e një ajsbergu, sepse në fakt pjesa më e madhe e veprës së saj, Monografia shkencore “Peshqit e Shqipërisë” e dërguar për botim nga autorja, nuk u botua kurrë dhe u tjetërsua pas vdekjes së saj. Gjej rastin të falenderoj Ambasadën e Italisë, përgjegjës në Bibliotekës së FSHN, z. Petro Luarasi dhe studiues të tjerë për ndihmesën në gjetjen e këtyre dokumentave që hedhin dritë mbi të vërtetën e aktivitetit shkencor të Sabiha Kasimatit.

DERI NË DITËT E SOTME KANË MBËRRITUR DY BOTIMET E SAJ:

“Fauna iktike e ujërave të ëmbla të Shqipërisë”, teze diplome e vitit 1940, e mbrojtur ne Universitetit e Torinos, Itali, dhe artikulli me temë: “Probleme te Peshkut dhe të Peshkimit në vendin tone”, botuar ne vitin 1948, ne Buletin e Institutit te Shkencave, institut ne te cilen Sabihaja punoi me perkushtim dhe pasion deri ne fund te jetes se saj.

Janë pak nga vepra e saj e mohuar dhe e tjetërsuar, por edhe kaq mjaftojnë për të kuptuar dhe vlerësuar dimensionin e kësaj studiuese të talentuar për kohën dhe periudhën në të cilën Ajo jetoi. Sabiha Kasimati ka qenë e para studiuese biologe që jetën e saj të shkurtër ia kushtoi studimit të peshqëve të vendit

tonë, dhe zhvillimit të peshkimit në baza shkencore dhe racionale.

Teza e saj e diplomës “Fauna iktike e ujërave të ëmbla të Shqipërisë” është një punim i shkëlqyer diplome, i shkruar me një gjuhë të pasur dhe korrektësi shkencore, në të cilën ajo demonstroi njohuri të thelluara mbi shkencën e Iktiologjisë dhe të mjedisëve me ujëra të ëmbla të vendit tonë. Në të ajo përcaktonte dhe përshkruante me kompetencë shkencore pjesën më të madhe të llojeve dhe nënlojeve, racave apo varieteteve, të peshqve të ujërave të ëmbla të vendit tonë, të mbledhura nga autorja në liqenet kryesore të vendit (Shkodër, Ohër, Prespë, Maliq, Tërbuf, Belsh) dhe rrjedhat e tyre lumore, përfshirë edhe peshqit e lagunës apo

Clupeidae (kublës, açuges, sardeleve etj), Familja Serranidae (e levrekeve), Familja Mugillidae (e qefujve), Familja Salmonidae (e troftave), Familja Anguillidae (e ngjallës).

Tema e saj paraqiste interes të veçantë duke patur parasysh se, deri atëhere, ende nuk ishte kryer ndonjë punë sistematike mbi këtë temë dhe as ishte hartuar ndonjë listë e llojeve që përbëjnë faunën iktike shqiptare. Puna kërkimore u parapri nga një përgatitje e detajuar dhe serioze, duke konsultuar të gjitha tekstet dhe artikujt e botuar mbi këtë temë nga autorë italianë, gjermanë, jugosllavë, apo autorë të tjerë, që autorja kishte patur në dispozicion në bibliotekën e Institutit të Zoologjisë të Universitetit të Torinos, ose nga miq e

dashamirës që jetonin jashtë vendit. Autorja kishte mbledhur edhe shumë ekzemplare të faunës iktike të ujërave të kripura në brigjet shqiptare dhe në lagunën e Butrintit, studim i cili, megjithëse i tejkalonte objektivat e temës së kësaj diplome, gjithsesi ishte bërë dhe paraqitur si një shtojcë e punimit të Diplomës. Materialit i bollshëm iktiologjik i mbledhur u shqyrtua dhe u studiua në mënyrë skrupuloze nga Autorja në laboratorin e Institutit të Zoologjisë dhe ashtu siç shkruan vetë autorja “... në disa raste ekzaminimi më ka lejuar të gjej karakteristika që nuk korrespondojnë plotësisht me ato të përshkruara nga autorët e përmendur në bibliografi,.....”.

Në këtë punim Autorja e ka gjykuar të përshtatshme të jap edhe një përshkrim të shkurtër të ambienteve të ndryshme ku jetojnë peshqit dhe ku u krye mbledhja e materialit biologjik. Autorja ka dhënë rezultate interesante jo vetëm në lidhje me madhësinë e variacioneve specifike brendallore, por edhe sepse shpesh ajo korrigjon disa pohime të autorëve që janë marrë me peshqit e



Materiale Studiate									
Altit	M	Lungh.	D	A	V	P	L.lat.		
Butrinti	1	162	III-8	III-8	I-8	I-15	37		
Belsh	1	150	III-8	III-9	I-8	I-13	39		
	1	126	III-8	III-9	I-8	I-13	39		
	1	125	III-8	III-9	I-8	I-13	39		

Faqe nga teza e diplomës së Kasimatit

ujërave të ëmbla. Bibliografia e pasur prej 71 burimesh të autorëve më të njohur të shkencës së iktiologjisë të kohës, dhe njohuritë e thelluara në iktiologji i lejuan asaj që me kujdes të plotësonte dhe korrigjonte gjetjet e studiuesve të njohur të asaj kohe si dhe të jepte një kontribut shtesë në pasurimin e përshkrimit të llojeve, nënlojeve dhe varieteteve të reja në vendin tonë, të papërshkruara nga autorë të tjerë më parë. Kështu, për shembull, autorja kishte konstatuar praninë e Barbus prespensis në liqenet e Maliqit, të Ohrit dhe në lumin Shkumbin, ndërsa studiuesit Karaman dhe Steindachner pohonin praninë e llojit vetëm në liqenin e Prespës. Apo faktin edhe më interesant, siç ishte prania e Solea vulgaris aegyptica (Chab. 1927) në ujërat e brigjeve shqiptare, që deri atëhere mendohej se gjendej vetëm në brigjet egjiptiane; në lagunën

Butrintit autorja kishte gjetur katër ekzemplare të këtij nënloji, me madhësi të ndryshme.

Studimi përmban edhe një paraqitje të hollësishme të vëzhgimeve të kryera mbi materialin e mbledhur. Për çdo lloj dhe varietet autorja ka përcaktuar karakteristikat dhe i ka paraqitur rezultatet e studimit në formë tabelare, ku për çdo lloj tregohet: numri i ekzemplarëve të studiuar, të ndara sipas vendit ku janë mbledhur; (ii) Gjatësia trupore e çdo individi (nga maja e turirit deri në fund të pendës së bishtit); (iii) Numri i luspave përgjatë vijës anësore nga kapaku i velëzave deri në bazën e pendës së bishtit; (iv) Numri i rrezeve të pendës shpinore (numrat romakë tregojnë numrin e rrezeve të



Aktiviteti për 105-vjetorin



Aktiviteti për 105-vjetorin

liqenit të Butrintit. Materiali mbledhur dhe ekzaminuar prej saj i përket të gjitha familjeve të peshqëve të urjave të ëmbla të vendit tonë, si Familja Acipenseridae (e Blinëve), Familja Cyprinidae (e Kraporeve), Familja

AKTIVITETI

Zbulohen fotot e panjohura të Sabiha Kasimatit



Sabiha Kasimati në moshë të re

E shtë përkujtuar dje 105-vjetori i lindjes së shkencëtares së parë shqiptare, Sabiha Kasimati, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Në këtë përvjetor, familjarët e shkencëtares së parë shqiptare kanë marrë dosjen e saj të plotë nga Arkivi i Shtetit, si dhe kanë publikuar për Report Tv fotot e panjohura të Sabiha Kasimatit. Fotot janë prezantuar nga Elsa Kasëmi, nusja e nipit të Sabiha Kasimatit gjatë aktivitetit të përkujtimit të 105-vjetorit të

lindjes së shkencëtares shqiptare që u pushkatua nga diktatura në vitin 1951. Sabiha Kasimati është e treta grua shkencëtare në botë, që është pushkatuar nga komunizmi. Elsa Kasëmi ishte pranishme në aktivitetin ku autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Ambasadën Italiane organizuan në Tiranë këtë të premte.

Në ceremoninë përkujtimore janë

sjellë edhe veprat shkencore të shkruara në Itali nga Sabiha Kasimati, ku u prezantua edhe tema e saj e diplomës. Në ceremoninë përkujtimore të “Sabiha Kasimatit është folur për figurën e saj si shkencëtare, veprën, përndjekjen nga diktatura e ë gjerë. Familjarët e saj Ina Kasimati, Kleri Kasimati dhe Elsa kasimati kërkuan që vepra shkencore e Sabiha Kasimatit që vitin 1947 është botuar me emrin e saj, të vërtetohet nga arkivat dhe t’i kthehet autorësia.



Sabiha Kasimati



Familjarët e Sabihës
Kleri dhe Elsa Kasimati

plota, numrat arabë numrin e rrezeve të degëzuara; (v) Numri i rrezeve të pendës anale; (vi) Numri i rrezeve të pendës së bishtit; (vii) Numri i rrezeve të barkut; dhe (viii) Numri i rrezeve të pendës të gjoksit.

Autorja me kompetencë paraqet disa shënime që ilustron ndryshimet e gjetura në lidhje me përshkrimet e bëra nga autorët e konsultuar rreth pamjes së jashtme, profilin dhe karakteristikave të tjera që nuk mbulohen nga karakteristikat e lart përmendura. Është interesante të theksohet se shumë shpesh karakteristikat e gjetura nga autorja, për mostrën tipike apo "holotipin", i tejkalojnë kufijtë e caktuar nga autorët të ndryshëm. Për secilën nga mjediset e ujrave të ëmbla, autorja jep një listë të specieve, nënspecieve dhe varieteteve apo formave që formojnë faunën iktike të tyre, si Peshqit e Liqenit të Shkodrës (23 lloje), Liqenit të Ohrid (19 lloje), Liqenit të Prespës (12 lloje), Liqenit të Maliqit (10 lloje), Liqenit të Belshit (6 lloje), Liqenit të Tërbufit (7 lloje).

Punimi përmbyllet me një pjesë të posaçme që Autorja i kushton kujdesit që duhet treguar për të njohur, vlerësuar dhe mbrojtur faunën iktike të ujërave të ëmbla të vendit tonë dhe vënë në baza racionale dhe shkencore peshkimin dhe pishikulturën në Shqipëri. Për këtë ajo parashtron edhe rrugët në të cilat duhet ecur, si:

1) Krijimi i stacioneve të riprodhimit artificial të peshqve për inkubimin e vezëve dhe rritjen e rasave

2) Krijimi i ndërmarrjeve të përpunimit të peshkut, të cilat do të mund të shërbenin si shembull dhe të inkurajonin përhapjen e metodave racionale të peshkimit, me përfitim ekonomik dhe jo të dëmshme.

3) Mbështetja e eksportit, veçanërisht me Italinë, e cila, në qoftë se do të kishte pasur mjete të përshatshme transporti dhe magazinimi, mundet që me përfitim reciprok, të thithte sasi shumë të mëdha të peshkut.

4) Shëndetësimi i zonave malarike përgjatë bregdetit, ku peshkimi mund të japë rezultate shumë më të mira në luftimin e kësaj sëmundjeje.

5) Rishikimi i legjislacionit të peshkimit, ndalimi i metodave të peshkimit tejet të dëmshme (përdorimi i dinamitit, lëndëve helmuese, gjuetia me rrjeta kositesë fundore) dhe ngritja e një shërbimi mbikëqyrës.

...rrugë këto që tingëllojnë aktuale edhe sot pas kaq vitesh e dekadash, por që mbi të gjitha janë dëshmi e dimensionit të jashtëzakonshëm intelektual dhe vizionar të Sabiha Kasimatit.

Në punimin e saj 8 vjetë më pas (1948) të titulluar "Probleme të peshkut dhe të peshkimit në vendin tonë", Sabiha Kasimati na shfaqet si një personalitet i spikatur dhe plot kompetencë në fushën e Iktiologjisë dhe peshkimit. Njohëse e thelluar e pasurive iktike të vendit tonë dhe luftëtare për ruajtjen e kësaj pasurie të vyer natyrore për Shqipërinë dhe shqiptarët, ajo në këtë punim brilant të shkruar me një gjuhë të pasur dhe kompetencë shkencore, jo vetëm që i bën një diagnozë gjendjes së peshkut dhe peshkimit në vendin tonë, por zhvillon edhe më tej vizionin e saj për ruajtjen, mbrojtjen dhe pasurimin e vlerave iktike të ujërave të ëmbla dhe të kripura, duke përvijuar drejtimet kryesore në të cilat duhet ecur, për t'a bërë peshkimin ashtu siç ëndërronte Sabihaja "...një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë sonë kombëtare... që do të kontribuojë esencialisht në pasurimin dhe mirëqenien e popullit tonë". Duke e përmbyllur fjalën time në këtë takim përkujtimor, mendoj se është detyrimi ynë si studiues që të ndriçojmë dhe ngremë në vendin që meriton vepra dhe kontributi shkencor i studiueses së talentuar Sabiha Kasimati dhe t'a bëjmë atë të njohur për brezat e sotëm dhe të ardhshëm të shkencës shqiptare. Në këtë kontekst, më lejoni që t'i shpreh mirënjohjen tonë të thellë Ambasadës Italiane në Tiranë për sjelljen në Shqipëri të tezes së diplomës së autores "FAUNA IKTIKE E UJËRAVE TË ËMBLA TË SHQIPËRISË", duke mundësuar që tashmë studiuesit e sotëm dhe të ardhshëm t'a njohin dhe t'i referohen asaj. Përgëzoj iniciativën e z. Petro Luarasi për përkthimin dhe botimin në shqip të kësaj diplome. Propozojmë që kjo diplomë, në gjuhën italiane dhe e përkthyer, të shpërndahet në Bibliotekën Kombëtare dhe të gjitha bibliotekat e universiteteve dhe qendrave kërkimore në vend për t'u njohur dhe referuar nga studiues vendas dhe të huaj të fushës së Iktiologjisë dhe Peshkimit. Gjithashtu, bashkohem me propozimin edhe të kolegëve të tjerë biologë të Departamentit të Biologjisë dhe Qendrës së Kërkimeve të Florës dhe Faunës që pavioni peshqve pranë Muzeut të Shkencave të Natyrës të marrë emrin e Sabihë Kasimatit dhe në të të vendoset një përkujtimore në nderim të kontributit të saj si Iktiologe e parë e Shqipërisë. Në këtë vit jubilar të 60-vjetorit të krijimit të Universitetit të Tiranës, emri i Sabihë Kasimatit do të kujtohet me nderim të veçantë në Konferencën e Shkencave të Natyrës dhe Teknologjisë që do të zhvillohet në datat 17-18 Nëntor, 2017.

*Autori i shkrimit Prof.Dr.F.Bego është zoolog, Zyrtar për Projektet Shkencore dhe Qendrat Kërkimore dhe Zhvillimore



Ja çfarë zbulohet te "Dosja" e Kasimatit

Skema e dënimit të 22 martirëve, që u vranë në datës 8 shkurt 1951

KASTRIOT DERVISHI
TIRANË

Dosja hetimore-gjyqësore në ngarkim të grupit të supozuar të hedhjes së dinamitit në legatën sovjetike është bërë publike qysh në vitin 1992. Madje është botuar disa libra me autorë të ndryshëm e janë bërë disa dokumentarë. Ajo nuk është dosje agenturiale operative, (sepse të gjithë personat që u listuan apo u ekzekutuan e kanë pasur dosjen në ngarkim), por një dosje e sajuar në mënyrë shumë primitive pas ekzekutimit të martirëve. Dosjet formulare të personave që u implikuan në këtë histori, me një përjashtim (edhe ky rast nuk ka informacion konkret, përveçse datës së ekzekutimit) janë asgjësuar në vitet '50. Kështu historia e 22 personave mesnatën e 25-26 shkurtit 1951, domosdoshmërisht kërkohen në burime të tjera.

Dinamin (gabimisht shumë thuhet "bombë") e hodhi organizata Bashkimi Kombëtar e kryesuar nga Sejfulla Shima. U zgjodh ajo kohë atentati për t'i dhënë një goditje regjimit komunist në kohën kur në Tiranë organizoheshin aktivitete për nder të Ushtrisë së Kuqe.

Ora 19.30 të datës 19 shkurt 1951 Hysen Llulla dhe Qazim Laçi u nisën me biçikleta drejt legatës sovjetike në rrugën e Durrësit në Tiranë. Hyseni hodhi dinamin me fitil 2 metra të gjatë, ndërsa Qazimi nuk mundi të hedhë gjë. Shpërthimin e kanë dëgjuar të dy kur ishin në lumin Lana. Zbulimi i këtij grupi u bë rastësisht pas dy javësh, vetëm sepse një anëtar i Bashkimit Kombëtar e tregoi ngjarjen në formë mburrjeje (po kjo është çështje tjetër) te një person tjetër.

Menjëherë pasi Byroja Politike vendosi mënyrën e veprimit si dhe dënimet me vdekje që do jepeshin, organet e punëve të brendshme në Tiranë nisën një valë arrestimesh me të cilat izoluan gjithë elementin antikomunist të menduar. Të arrestuarit për këtë ngjarje shkuan rreth 170 persona (lista unike kryesore), përfshi ata para ngjarjes që dyshoheshin për një veprim të datës 8 shkurt 1951, por nuk rezultoi kurrkund të jetë i vërtetë. Historia e kësaj ngjarjeje nuk mund të njihet kurrsesi e veçantë, por e integruar me 170 personat e tjerë. Në këto arrestime mungonin pikërisht anëtarët e organizatës që hodhi dinamin, gjë që tregoi mungesën e inteligjencës së organeve të Sigurimit dhe syleshtësinë tipike karakteristike të tyre. Organet e punëve të brendshme përpiluan tri lista nga kontingjentet "armike". Duke menduar se patjetër armiku duhej të ishte këtu, u përzgjedhën për t'u pushkatuar 22 persona, ndërsa 2 të tjerë u ekzekutuan në një proces të mëvonshëm (jashtë tri listave, por pjesë e grupit prej 170 personash). Nga Instituti i Shkencave ishin përzgjedhur tre

persona, njëra nga të cilët ishte shkencëtarja Sabiha Kasimati (dy të tjerët, me histori shumë interesante kaluan në procese gjyqësore të veçanta). Sabihaja u mor në pyetje nga shefi i seksionit të Degës së 2-të, Koli Shuke (me profesion rrobaqepës). Listat u përpiluan në këtë mënyrë:

A-LISTA E PARË, "AGJENTËT E TË HUAJVE"

Dega e 1-rë (Zbulimi Politik) drejtuar nga Zoi Themeli (me profesion furrxhi) dhe Dega e 5-të (legatat e huaja) drejtuar nga Delo Balili përpiluan një listë të përbashkët me gjithsej 19 persona. Nga kjo listë u ekzekutuan: Tefik Shehu, Hekuran Troka, Lluka Rashkoviç, Haki Kodra, Thoma Katundi, Mehmet Ali Shkupi, Gjon Temali, Fadil Dizdari.

B-LISTA E DYTË, BALLISTËT, LEGALISTËT, PRONARËT

Dega e 2-të Dega që drejtohej nga Niko Ceta (me profesion furrxhi) me zëvendës Rasim Dedjen (me profesion rrobaqepës) përpiloi një listë me gjithsej 10 persona. Nga kjo listë u ekzekutuan: Ali Qorralliu, Zyhdë Herri, Gafur Jegeni, Jonuz Kaceli, Sabiha Kasimati.

C-LISTA E TRETË, NËPUNËSIT "SABOTATORË"

Dega e 3-të (Mbrojtja e Ekonomisë Socialiste) që drejtohej nga Edip Çuçi (me profesion specialist djathi) përpiloi një listë me gjithsej 12 persona, kryesisht nëpunës në ministri apo ndërmarrje. Nga kjo listë u ekzekutuan: Pjerin Guraziu, Qemal Kasoruho, Anton Delhysa, Niko Lezo, Myftar Jegeni, Manush Peshkëpia.

Kryengritja e Postribës, me 9 shtator 1946 është trajtuar shpesh vitet e fundit, ndërsa një vëmendje e posaçme ju dha këtë vit në një aktivitet me rastin e 71-vjetorit të kësaj ngjarjeje, mbajtur në Muzeun Historik Kombëtar. Dëshmi të shumta e fakte dokumentare janë publikuar për organizmin e kësaj kryengritjeje, e cilësuar si një ndër të parat kundër komunizmit në Europë.

Në katër numra të gazetës Shqiptarja.com, botuam këto ditë fjalën e mbajtur në këtë aktivitet nga Hamza Kazazi, djali i Jup Kazazit, drejtuesit të kësaj kryengritjeje, ndërsa sot sjellim një dokument që jep të dhëna të rëndësishme mbi këtë ngjarje. Çfarë raportoni në Komitetin Qendror njerëzit e partisë dhe drejtuesit e Sigurimit të Shtetit që atëkohë quhej "Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit"? Spiro Pano, në emër të Komitetit Qarkor të Partisë raportonte me detaje se çfarë kishte ndodhur me 9 shtator në Postribë dhe si po perceptohej në popull kjo ngjarje, e rrjedhimisht se si duheshin organizuar për ta frenuar e për të parandaluar çdo tentativë tjetër të këtij lloji.

Më poshtë e sjellim të plotë këtë raport të Spiro Panos, një dokument i cili ruhet ën AQSH mes shumë shkresave të tjera që dëshmojnë aksionet në veri të Shqipërisë për eliminimin e gjithë kundërshtarëve të komunizmit.

DOKUMENTI I PLOTË KOMITETI QARKOR I P.K.SH.


VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
PËR SHKODRËN
Nr. 503/1
Shkodër më 14.9.1946
Komitetit Qendror të P.K.Sh.
Tiranë
Të dashur shokë,
Në vijim të shkresës s'onë Nr. 503 dt 9.9.1946, ju japim këto njoftime të reja rreth goditjes s'ilegalëve afër kazermave t'ona:

Si del sot, dhe në bazë të informatave të fundit, numri i atyrvë që kanë marrë pjesë në aksion nuk qenë 50 për gati 300 veta nga katundet e komuneve Postribë e Gur'i zi. Udhëheqësi i aksionit na del Jup Kazazi dhe rreth tij një pjesë e mirë kulakësh, tipa kapadainjsh, tregtarësh të tatuar, oficerash të Zogut etj. Këta nuk ishin të gjithë të gjithë të armatosur. Nga sa njoftohemi këtyre _____ u është paraqitur situata e përmbysur këtu, sikur gjoja Greku hyri në Shqipëri, Englezi zbarkoi në Durrës e kështu nuk mbetesh tjetër veç se të hynin në Shkodër.

Gjithashtu nuk na del si diçka e shkëputur në lidhje me mobilizimin vetëm, por si diçka në lidhje me gjithë situatën e jashtme, mbassi ditët e fundit informohemi se të tilla aksione do të bëhen gjoja në Lesh Koplik e gjekët. Ne shkruam me Zoin në Lesh dhe pakë se ka një farë lëvizjeje ilegalësh dhe miqsh të tyre në qytet. Shokët e kanë shtruar dhe kanë marrë disa masa. Ne u dhamë dhe udhëzime të tjera, në mënyrë që të goasim tashti, para se të na godasin ata. U-vumë në dukje pësimin



Jup Kazazi



DOKUMENTI I 1946

KRYENGRITJA E POSTRIBES, JANE 300 VETE, I UDHEHEQ JUP KAZAZI

Raporti i 14 shtatorit pak ditë pas shtypjes së kryengritjes së postribës. Si ndodhi, kush e organizoi, ku u shtri, ç'lidhje kishin drejtuesit e saj dhe si po perceptohej në popull...

t'onë në Shkodër dhe kujdesin që duhet të ketë organizata, për të mos e pësuar për të dytën herë.

Nga këto veprime ne nxjerrim këtë përfundim:

1. Dobësin e organizatës s'onë në fshat. Të bëhet një aksion i tillë, ose më mirë kjo përgatitje dhe ne të mos marrim vesh, do të thotë se ne jemi mjaft të dobët në fshat dhe gjer diku e në qytet. Kjo i është vënë në dukje organizatës që në ditën e parë. Është shtruar në qarkor dhe në Komitetin e Qytetit, por gjer më sot nuk është zgjidhur (problemi i periferisë). Bazat t'ona janë të dobëta këtu, fshatarët e mesëm dhe pasanikë janë të lidhur me Jupin

dhe këta kanë me vehte dhe fshatarë të varfër injorantë e të lëkundur. Ne kemi një çelulë fshati me 6-7 veta dhe kjo çelulë kontrollon 70 katunde të qendrës; kemi dhe aktive të rinis komuniste por të pakta dhe të okupuara me punën e garavet, të rrugës Kukës Peshkëpi etj.

Kjo çelulë nuk është ndihmuar sa duhet. Komiteti i Qytetit nuk e lot rolin e tij drejtonjës, prandaj dhe ne kemi propozuar ndryshime në këtë Komitet. Ky Komitet nuk e sheh dhe aqë drejt situatën dhe nuk ka mundur të forcojë bazën e tij në fshat.

2. Pastaj vetë ne të qarkorit dhe të Mbrojtjes nuk mendonim se mund

të mbrinin reaksionarët gjer këtu. Prova e asaj nate nxori në shesh fajin t'onë dhe na dha të kuptojmë se edhe pakujdesia më e vogël na kushton. E drejta është që ne nuk dinim gjë mbi këtë përgatitje, organizata gjer më 8 Shtator vazhdonte punën e qetë, sikur të mos ndodhte asgjë. Puna e mobilizimit ecte me rregull dhe gjer në atë ditë nuk ishte vërtet dezertim. I kishte thënë shokut Nesti Kopali nga Komiteti i Partisë se "flitet që më 9 do të sulmohet Shkodra" por të tilla fjalë janë dëgjuar dhe herë të tjera dhe nga ne quheshin të pabesura (duke marrë parasysh sukseset që kemi patur ne në Shkodër kohët e fundit: në manifestimet

e protestës që ishin më se të gjalla muarën pjesë nga 20.000, 10.000 qytetarë e fshatarë, dy tri herë me rradhë, parulla nuk para dëgjoheshin, lëvizjet e reaksionit ishin bërë më të ralla e me shumë ruajtje puna vullnetare ecte më me rregull, në pushtet ishin bërë pastrime etj nuk mendonin se armiqt do t'ishin aq të marrë sa të ndërmerrnin një aventurë të tillë. Kjo u-bë dhe ky pësim do të bëhet për ne mësim i mirë. Ne nuk na e thanë këtë fjalë, veç se të nesërmen e sulmit mbi Shkodër. Nesti vetë nuk i ka dhënë rëndësi dhe e ka lënë në heshtje.

3. Mëndje lehtësin e shokëve të fshatit dhe mungesën e vendosmëris

Paqe te Partizani, Alban Hoxha kërkon falje dhe dorëzon shiritin

Zgjidhet konflikti mes portierit e kapitenit të skuadrës dhe klubit të kuq

Alban Hoxha një kapiten i vërtetë. Portieri i Partizanit në prononcimin e parë publik të ditëve të fundit, sqaron situatën dhe merr një vendim të papritur. Hoxha dorëzon shiritin e kapitenit duke dhënë shembullin se ambicjet personale nuk mund të interferojnë në objektivat e klubit. Një gjest që synon gjithashtu të qetësojë dhe qartësojë situatën në kampin e kuq pasi Hoxha është një prej emrave më të dashur të tifozerisë së Partizanit dhe përjashtimi i tij për thyerje të rregullores sigurisht që shërbeu për të krijuar jo pak hamendësime për situatën në dhomën e zhveshjes së Partizanit. Në një prononcim për faqen zyrtare të klubit, Hoxha thekson. "Klubi ka vendosur një rregullore të brendshme, të cilën unë dhe shokët e mi duhet ta respektojmë. Kur kjo rregullore nuk respektohet unë marr përsipër përgjegjësitë. I kërkoj falje klubit, stafit teknik dhe shokëve të skuadrës. Për këtë arsye dorëzoj edhe shiritin e kapitenit për të dhënë shembull për të gjithë. Jam gati të rikthehem në vendin tim, pranë skuadrës dhe të jem në dispozicion të klubit, trajnerit dhe ekipit për të mirën e Partizanit". Një vendim prej një kampioni të vërtetë. Alban Hoxha mbyll përfundimisht një çështje që mund të rrezikonte ambjentin e kuq duke e pranuar të punojë për të mbrojtur me dinjitet ngjyrat e skuadrës që përfaqëson. Tashmë që Partizani dhe Hoxha janë sqaruar përfundimisht, trajneri Mark Iuliano mund të fokusohet tërësisht te sfida e javës së dytë kundër Kukësit ku me shumë mundësi, numri 1 do të rikthehet të mbrojtë



katërkëndëshin e Partizanit. Tashmë që Hoxha ka dorëzuar shiritin, çështja e kapitenit duhet të marrë një zgjidhje të shpejtë dhe emri i parë në listë për të qenë pasuesi i numrit 1 është mesfushori dhe zv/kapiteni Idriz Batha. Gjithsesi, me lënien në stol të

numrit 10 në ndeshjen e parë të sezonit, trajneri italian la të kuptohet se lojtari i lindur në Gjirokastër nuk është në preferencat e tij dhe nëse kjo rezulton e vërtetë, atëherë dy emrat më të mundshëm për të vendosur në krah shiritin janë Labinot Ibrahimi dhe

Arbnor Fejzullahi. Ky i fundit nuk do të jetë në dispozicion të trajnerit 2-3 javë pas dëmtimit të pësuar në gju në ndeshjen e Kupës kundër Naftëtarit duke humbur dy sfida të rëndësishme për të kuqtë, atë ndaj Kukësit por edhe ëprballjen me Skënderbeun.

LEGJENDA E BASKETBOLLIT

Presidenti Meta nderon Agim Fagun rastin e 70-vjetorit

Agim Fagu nderohet nga Presidenti Ilir Meta, me rastin e 70-vjetorit të lindjes, në një ceremoni të zhvilluar në ambientet e institucionit më të lartë të shtetit. Legjendës së Basketbollit shqiptar, iu dorëzua dekorata "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" me motivacionin: "Mirënjohje dhe vlerësim të thellë për veprën dhe kontributin madhor që ka dhënë për ngritjen e sportit të basketbollit në nivelet më të larta ndërkombëtare dhe si personalitet i shquar në njohjen dhe lartësimin e vendit tonë në botë". "Pak ditë më parë mora një kërkesë të nënshkruar nga personalitete

të jashtëzakonshme të jetës institucionale të sportit, kulturës, të arsimit në mënyrë të veçantë që udhëhiqej nga Presidenti Moisiu ku mua më bëri përshtypje një apel brenda kërkesës dhe vlerësimit për këtë figurë dhe personalitet të jashtëzakonshëm ku thuhej 'Zoti President ka dekorata që nderojnë njerëzit, por ka dhe njerëz që nderojnë dekoratën dhe Agim Fagu është pikërisht një i tillë.' Një sportiv i madh në fushë, por po kaq i madh edhe si përfaqësues i shqiptarëve nëpër botë Agim Fagu tha se ky nder qi i bëhet u përket të gjithë atë që lartësojnë im-

azhin e Shqipërisë e veprat e tyra. "Do të uroja që kjo ceremoni të shërbente si një mesazh për shqiptarët kudo ku janë që ata të kuptojnë që kjo ceremoni u thotë atyre se kontributi i veçantë, por i vërtetë i qytetarëve në Shqipëri do të vlerësohet gjithmonë në mënyrën e duhur. Pavarësisht se dekorata është nominative, unë mendoj se ajo është dhe një mesazh për të gjithë djemtë dhe vajzat shqiptare të brezave tanë që me punën kontributin pasionin dhe talentin e tyre e transformuan Shqipërinë në arsim, shkencë, art, sport dhe kulturë. Gjatë ceremonisë u shfaq një dokumentar mbi jetën



e Agim Fagut, me pamje të vecanta që nga jehona e ndeshjes ndaj Oran Soden, ku shënoi 48 pike, e deri tek roli i tij si diplomat në procesin e integrimit të Shqipërisë në NATO.

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Qeshët me fjalimin e Agron Shehaj? Dëgjoni bëmat e djalit të Fahrit/VD
- Grupi i PD rrëzon Berishën kundër zbulimit të tradhtarëve
- Gazeta austriake: Në Ballkan frikë nga Serbia, për Ramën sfidë negociatat
- Videoja që po "thyen" rrjetin, shikoni çfarë bën vrasësi
- Vermosh, IKMT prish shtëpinë e heroit, banorët në protestë: Turp
- FOTO/Vdesin në aksident dy politikanë serbë nga Kosova
- Terrorizmi godet sërish Londrën, shumë të plagosur në metro/ VD
- Ikën nga burgu në Greqi, rikthim me armë dhe drogë
- A e trembën sulmet e Berishës? Ja si përgjigjet Lulzim Basha/VD
- Horoskopi për datën 15 shtator çfarë parashikojnë yjet për ju sot

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Plagosi me armë biznesmenin në burg efektiv i policisë
- Emigrantët shqiptar, zyrtari britanik takon ministrin Xhafaj
- Qeshët me fjalimin e Agron Shehaj? Dëgjoni bëmat e djalit të Fahrit/VD
- FMN kundërshton Ramën, s'arrin dot premtimin për rritjen e GDP
- Pezullohen "policët gri", Gjignuri firmos: Ristrukturim institucionit

VIDEOT MË TË KLIKUARA

Itali, përplasat për vdekje nga një makinë një i ri shqiptar



Plagosi me armë biznesmenin në burg efektiv i policisë

Moti, rritje temperaturash parashikimi për ditët në vijim




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZHI I DITES

A e mbështesni nismën e PD për të dënuar krimet ndaj njerëzve nga komunizmi?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampioneve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.951
KOMENTET E DJESHME

334 101
TOTALI LIKE



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 38 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

- HORIZONTAL**
- Janë si Monte Carlo.
-Inicialet e Whalberg.
 - Mbahen në mbledhje.
-Fraza pa çifte.
-Në mes të dhomës
 - Është diletant.
-Kanë kaluar me armikun të tillë
 - Mbyllin një dritare.
-Luajnë ndeshjen e fundit.
 - Është toka e bregdetit.
-Mickey Mouse në një... FIAT.
-Fillojnë romanin.
 - Diftong në dietë.
-Gadishulli ynë.
-Janë në modë.
 - Në takim kur s'është ai.
-Një instrument për jazz.
-Grupi i Jon Anderson.
-Hesap pa kufij.
 - Kujt ia ka... ka kënaqësi.
-Jonathan regjisor.
-Istitucione Rajonale Sociale.
 - Lidhen në krye.
-Poeti i Didona e braktisur.
 - Nuk ka shenjtor në desktop.
-Egoyan regjisor
-Nota e diapazonit.
 - Fitohet nga ciklisti.
-Dy herë në skenë.
-Gëllojnë nga klounët ato të cirkut.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

S	K	U	T	A		A	L	A	N		O		S	A	R	A
H	A	R		G	A	R	A	T		J	R	P		D		L
A	N	A	L	I	Z	A	T		D	E	M	I	S		F	B
K	A	L	A	M	A			D	E	M	O	N		T	R	A
A	L	E	T	E		E	L	E	M	E	N	T	A	R	E	
J		T	I	T		K	O	M	A	N	D	A	N	T	E	T
A	S		N		P	I	L	O	T	I			E	M	E	
	I	L		P	A	P	I	N			N	K		B	A	R
	P	I	N	A	K	O	T	E	K	A		A	N		N	E
H	A	B	A	N	E	R	A		O	R	A	T	O	R		N
E	R	I	N	I	T	E		D	R	A	M	A	T	I	K	E
M	I	A		K	A	T	E	R		B	A	R	A	K	A	T

- Kështu thirrej Jupiteri.
-Kanë strehë për një... kokë.
- VERTIKAL**
- Kishte modele Frinën.
 - Memoria në computer.
-Mund të jenë të mesem.
 - Është kapa.
 - Inicialet e Duras.
 - Total pa ekstreme.
 - Përpilo akte materiale.
 - Janë mballoma.
 - Kroacia në tabela.

- Një lidhëz.
 - Litra pa kufij.
 - Fillojnë bashkë.
 - Mbyllin një sirtar.
 - Presin pa çifte.
 - Një biçikletë dyshe.
 - Mbyllin kanatat.
 - Mund të kenë edhe kalimtare.
 - Është trupi i...ambasadorit.
 - Një patriark biblik.
 - Kufijtëv e matjes.
 - Derisa mbarojnë.
 - Marcelo te Juventus.
- Janë edhe macet.
 - Një mund të jetë kardiak.
 - Faliero, doge i famshëm.
 - Janë gjiarët.
 - Doktori i Sherlock Holmes.
 - Jules i një kupe bote në futboll.
 - Janë në botë.
 - Beson pa kufij
 - Në mes të një kanali.
 - Janë si matadores.
 - Pak latinisht.
 - Janë për mësimin e gjuhës.
 - Arte pa re

FJALËKRYQI SPORTIV

	1		2		3		4	5	6		7	8	9
					10	11		12			13		
					14	15		16			17		
					18					19			
					20					21			22
					23	24				25			26
					27					28	29	30	
					31					32	33		34
					35					36			37
					38					39			40
					41					42			

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

K	O	K	U	R	I		S	P		P	D
U	A		A	K		P	A	N	O		I
E	R	E	N	D	E		P	A	R		I
P	O	R	T	I	E	R	I	L	I	E	G
Q	U	A	R	T	E	R	B	A	C	K	S
S	H	A	R	R	A		K	A	E	K	A
T	E	R		A		A	V	T			
O	T	P	A	R	D	R	R	A			
L	M	A	R	K	I	U	L	I	A	N	O
I	I	L	I	R	D	A	J	A		I	R

HORIZONTAL

- Një mund të jetë shënimi.
 - Gerti basketbollist.
 - Një top në rrjetë
 - Ian Fleming
 - Navratilova ish-teniste.
 - Përfaqësohet nga Butrinti.
 - Gjysma e tagrit
 - Një sport me brez të zi
 - Federico te Roma
 - Një big match në Seriëe A
 - Maurizio trainer italian
 - Gjysmë alarmi
 - Conte trainer
 - Në krye të klasifikimit
- Dushku aktore
 - Fillojnë një motiv
 - Kështu fillon periudha
 - Andi futbolist
 - Personazhi në foto
 - Poeti kur nuk pi
 - Personazhi në foto

VERTIKAL

- Rastisur në krye
- Skuadra e Ze Maria-s
- Pak imagjinatë
- Fillojnë matanë
- Dobroshi aktore
- Buffon portier
- Fillon nga fundi
- Pak latinisht
- Është vija e portës
- Nuvolari që qe pilot
- Khedira mesfushor
- Është tokë buke
- Shteti me Kathmandu
- Është skuadra e Skënderbeut
- Luhën për trofeun
- Robert Redford
- Skuadra e Igli Tares
- Fillojnë goditjen
- Makina Felicia
- Oerter që hidhte diskun
- Skuadra e Ferrara-s
- Ilion Lika
- Gjysmë mesore
- Pak enigmatike
- Arte pa re
- Ekstreme në burg
- As unë as ti
- Kufizojnë çarjen
- Kështu fillojnë ilustrimet

SUDOKU

LOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

PËRGJIGJE

8	3	4	1	5	7	2	9	6
5	2	1	8	6	9	4	7	3
6	9	7	3	2	4	1	5	8
1	6	5	2	9	3	7	8	4
7	8	3	6	4	5	9	2	1
2	4	9	7	1	8	3	6	5
4	7	8	5	3	2	6	1	9
3	1	2	9	8	6	5	4	7
9	5	6	4	7	1	8	3	2

4				3	2	7				5
	1	5						3	2	
2	3			1		8			9	6
				8		6				
	4	3		1			6	8		
				2		4				
1	7			6		2			4	3
	8	4					2	6		
5				9	4	3				8

HOROSKOPI

DASHI



Do tregoheni shumë striktë në dashuri sot dhe shpesh do e vini partnerin/en në siklet. Mos e teproni nëse nuk doni të keni mosmarrëveshje të mëdha. Beqarët do duhet të marrin disa vendime të cilat mund t'ua ndryshojnë përfundimisht jetën. Në planin financiar gjërat do shkojnë më së miri.

DEMI



Dialogu nuk do mungojë për asnjë moment sot në lidhjen që keni krijuar. Nga ana tjetër partneri/ja do iu joshë gjatë gjithë kohës dhe do iu bëjë të ndiheni më së miri. Beqarët nuk duhet të pranojnë çdo lloj ftese pa qenë të sigurtë për personat. Në planin financiar shmangni shpenzimet e tejskajshme.

BINJAKËT

Nëse mendoni se ka ardhur koha ta zyrtarizoni lidhjen tuaj flisni seriozisht me atë që keni në krah dhe bëjani të qartë gjërat. Boll më duke e shtyrë kohen pak e nga pak. Beqarët do jenë të privilegjuar në dashuri. Edhe pse nuk e kane kërkuar me ngulm princin i kaltër do mbërrijë. Financat do duan më shumë kujdes dhe maturi.

GAFORRJA



Marrëdhënia në çift do përmirësohet mjaft gjatë kësaj dite. Do flisni për gjithçka me partnerin/en tuaj dhe do i harroni problemet që keni pasur dikur. Beqarët do i japin me shumë prioritet jetës familjare dhe miqve. Dashuria për ta do jetë në vend të dytë. Dielli do iu ndihmojë ta përmirësoni situatën financiare.

LUANI



Do keni disa përballje të vogla sot me atë që keni në krah, megjithatë nuk pritet asgjë alarmuese. Mos mendoni gjithmonë se jeni iu që keni të drejtë. Beqarët do kenë mundësi ta gjejnë shpirtin e tyre binjak. Bëjini sytë katër. Financat do jenë mjaft të luhatura. Nuk është momenti i duhur për të kryer shpenzime.

VIRGJËRESHA



Plutoni do jetë i vendosur keq në qiellin tuaj të dashurisë dhe problemet ndërmjet jush dhe partnerit/es do jenë të mëdha. Mos u nxitoni për asgjë. Beqarët do kenë takime mjaft impresionuese me persona të veçante. Problemet materiale duhet t'i zgjidhni sa më shpejt të mundni. Edhe shpenzimet duhet t'i ulni.

PESHORJA



Jeta juaj sentimentale do jetë e mbushur me surpriza të këndshme sot. Do jeni të gatshëm të bëni edhe ndonjë çmenduri të vogël vetëm që atmosfera të nxehet. Beqarët do jenë më të mbyllur në vetvete dhe nuk do përfitojnë nga ftesat që do iu bëhen për të dale. Financat nuk do jenë në gjendjen e tyre të mirë.

AKREPI



Do jeni me humor shumë të mirë gjatë kësaj dite dhe do argëtoheni pa fund me personin që keni në krah. Çdo moment do jetë i veçantë dhe emocionues për ju. Beqarët do jenë gjithë kohës në kërkim dhe do i studiojnë mirë personat që do takojnë. Në planin financiar duhet të tregoheni më vigjilentë se kurrë më parë.

SHIGJETARI



Jeta juaj sentimentale do ndjekë drejtimin e duhur sot. Jupiteri do iu nxitë të tregoheni më të hapur dhe t'i pranoni më lehtësisht mendimet e atij që keni në krah. Ai nga ana e tij do iu surprizojë gjithë kohës. Beqarët nuk do hedhin asnjë hap pa qenë të sigurtë. Financat nuk do jenë të mira, kujdes me shpenzimet.

BRICJAPI



Ndryshime rrënjësore do ketë sot në jetën sentimentale të çifteve. Ata që kanë pasur debate do ndihen më të qetë, ndërsa ata që kanë pasur një lidhje të qëndrueshme do bëjnë plane për të ardhmen. Beqarët do kenë surpriza të këndshme. Në planin financiar çdo gjë do shkojë më së miri.

UJORI



Çiftet do gjenden përballë disa zgjedhjeve të vështira, por që duhet t'i bëjnë sot me patjetër. Mendohuni sa të mundni, por jo vetëm për veten tuaj. Beqarët do pëlqejnë jashtë mase një person që sapo ka filluar një angazhim serioz. Mërkuri do ndikojë tek financat dhe do i mbajë ato gjithë kohës të qëndrueshme.

PESHQIT



Nëse jeni në një lidhje mos kërkonit të impononi mendimin tuaj mbi partnerin/en sepse do keni mosmarrëveshje të shumta. Pranojini sugjerimet e tjetrit dhe toleroni. Beqarët do kenë një ditë të zakonshme dhe pa ndonjë takim impresionues. Në planin financiar duhet të vazhdoni të tregoheni të matur.

PËRGJIGJE

A	D	O	N	I	S		R	E	A	L	E	T
R	O	T					M	I	G	R	E	N
T	R	U	K		M	E	D		T	R	T	
I	A		A	N	A	T	O	M	I	A		D
S		A	N	A	T	O	L	E		P	O	
T	R	A	G	J	E	D	I		I	K	U	R
I	R	U	S	A	N		D	A	L	I		
K	A	R	M	A	T	I	M	E	T			
E	U	E	T		J	A	R	A	N			
L	T	O			P	E	L	O	P	I		
G	I	L		N	G	A	S	T	E	R	N	
K	U	L	T	U	R	A		E	T	I	K	A

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

17	4	5	4		12		6	3	12	14	8	7
	10	4	5	7	3	6	4		3		8	
10	8	1		3	5	2		6	5	2	12	4
4		17	4	7	1	17	1	2	1	6		5
1	9	3	5	4	1	8		12	2	7	7	3
17	2	5	5		17		14		9	8	3	13
2		15	3	12	3	5	8	7		7	6	
9		16	9		16	2	7	4	6			14
	10	8	9	4	3		4	16	2		10	S
6	2	5	8		9	8	7	8	5		8	E
4	15	8		8	9	5		5	3	1	3	A
7	10		1	3		3	3		12	2	7	T

VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!



BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War



BUNK'ART 2

- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



Ku ndodhet BUNK'ART 1?
Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë



Ku ndodhet BUNK'ART 2?
Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë

www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime / Reservations:

+355 (0) 67 20 72 905

